

UDHËZIM
Nr. 1, datë 1.2.2013

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 89, DATË 16.1.2013
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË, TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHKETEN
DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2013”

Në mbështetje të VKM. Nr .89 Datë 16.01.2013 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektoreve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”

UDHËZOJMË:

I. Të përgjithshme

I. Fondet e miratuara, në Buxhetin e vitit 2013, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit.

II. Sektorët, që do të mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të jenë:

- a) Prodhimi i frutave, arvoreve, shegës, ullinjve dhe rrushit;
- b) Prodhimi i perimeve në serra;
- c) Prodhimi i qumështit, vajit të ullirit dhe mjaltit;
- d) Përmirësimi racor në blegtori;
- e) Prodhimi i produkteve organike;
- f) Nxitja e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë
- g) Nxitja e kooperimit bujqësor;
- h) Mbarështrimi i kërmillit.
- i) Prodhimi dhe grumbullimi i bimëve medicinale.

III. Masat e mbështetjes dhe masa e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në shkallë vendi, të jenë, si më poshtë:

1. Për mbjellje ullishtesh, në vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe në vlerën 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale;
2. Për mbjellje arrash, në vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) leke/ha për mbjelljet me fidanë të shartuar, dhe në vlerën 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha, për mbjelljet me fidanë të pashartuar në të gjithë vendin;
3. Për mbjellje ekstensive lajthish dhe shegësh, në vlerën 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha;
4. Për mbjellje intensive lajthish dhe shegësh, në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha;
5. Për mbjellje mollësh, dardhash, kumbullash, qershish, pjeshkësh dhe ftonjsh në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha;
6. Për mbjellje agrumesh, kivi dhe luleshtrydesh, në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit;
7. Për mbjelljen e vreshtave, në vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë) mijë lekë/ha;

Sipërfaqja minimale e mbjellë me bimët e përshtuara sipas masave 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij kreu, duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) dynym.

8. Për ujitjen me pika në aroret, lajthitë, bajamet e shegën, pemtoret, agrumishtet, ullishtet (vetëm për format intensive të kultivimit të tyre), dhe serrat me ngrohje diellore dhe teknike, në vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë), lekë/ha. Sipërfaqja minimale të jetë jo më pak se 5 (pesë) dynym;
9. Për prodhimin e vajit të ullirit extra i virgjër, në vlerën 100 (njëqind) lekë/litër, për sasi të prodhimit deri në 15 (pesëmbëdhjetë), tonë/vit;
10. Për prodhimin e produkteve organike bujqësore nga bimët e kultivuara në vlerën 70,000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/fermë;
11. Për blerjen ose zëvendësimin e plastmasit për serrat me ngrohje diellore dhe teknike (në shkallë vendi), në vlerën 400,000 (katërqind mijë) lekë/ha. Sipërfaqja minimale të jetë 2 (dy) dynymë;
12. Për blerjen e plastmasit për prodhimin e bostanoreve në tunele, në vlerën 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë), lekë/ha, për fermerët që mbjellin jo më pak se 5 (pesë) dynym bostanore;
13. Në vlerën 10 (dhjetë) lekë/litër qumësht, për fermat blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë qumështi të matrikulluara të racave të pastra apo kryqëzimet

e tyre, por financimi të bëhet për jo më shumë se 80 (tetëdhjetë) krerë. Paga të bëhet kundrejt sasive të qumështit, të deklaruara në organet tatimore;

14. Në vlerën 500 (pesëqind) lekë/krerë dele ose dhi të matrikulluara për fermerët, të cilët mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 300 (treqind) krerë;
15. Në vlerën 5,000 (pesë mijë) lekë/krerë dele ose dhi race e pastër për fermat që mbarështojnë mbi 10 (dhjetë) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë;
16. Në vlerën 5,000 (pesë mijë) lekë/krerë për vicat për majmëri për fermat që mbarështojnë mbi 10 (dhjetë) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë;
17. Në vlerën 600 (gjashtëqind) lekë/koshere blete për fermerët me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere bletë;
18. Në vlerën 20,000 (njëzet) mijë lekë për kokë mëshqere, racë e pastër, të moshës mbi 15 (pesëmbëdhjetë) muaj në zona të caktuara ku ekziston përqëndrimi më i madh i gjedhit, për fermat ose grup fermash blegtorale që prodhojnë jo më pak se 3 (tri) mëshqera por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë;
19. Mbështetja, përmes subvencionit, në masën 70% të normës së interesit, për 5 (pesë) vite radhazi, për kreditë deri në 25,000,000 (njëzet e pesë milion) lekë, që do të merren për aktivitetet e mëposhtëme:
 - a. Ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, kërpudhës dhe bimëve medicinale;
 - b. Mjetet mekanike bujqësore, agregate dhe tank ftohës për qumështin;
 - c. Peshkimin dhe përpunimin e produkteve ujore;
 - ç. Veprimtaritë në agro dhe ekoturizëm
20. Për grumbullimin e gështenjës, boronicës dhe shëgës, në vlerën 1,200 (një mijë e dyqind) lekë/kv. Paga të bëhet vetëm kundrejt sasive të gështenjave, boronicave dhe të shëgëve të shitura me faturë tatimore;
21. Për mbarështimin intensiv të kërmillit, në masën 50% të vlerës së rasatit për ha, por jo më shumë se 500,000 (pesëqind mijë) lekë/ha. Kjo mbështetje të jetë për ata që fillojnë investimin për mbarështimin e kërmillit për herë të parë. Për mbarështuesit që e kanë bërë investimin fillestar më parë të vihet mbështetje e fermave që bëjnë mbarështimin intensiv të kërmillit me një vlerë 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;
22. Për mbjellje të bimëve medicinale të kultivuara si sherebelë, lavanda, timus, rigon dhe rozmarinë, në bllok e sipas zonave të përcaktuara më parë për kultivim, në masën 50% të kostos totale të projektit, por jo më shumë se 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha;
23. Për mbështetjen e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor për projekte për ngritje ambientesh për ruajtje të prodhimit, linja për standartizim prodhimi dhe mekanikë

bujqësore, të financohet deri në masën 50% të projektit, por jo më shumë se 5,000,000 (pesë milion) lekë për një subjekt (ShBB).

IV. Projektet e vlerësuara dhe të papaguara gjatë vitit 2012, për mbjelljen e arvoreve, shëgëve, subtropikaleve, ullinjve, pemëve frutore, vreshtave dhe bimëve medicinale që plotësojnë kushtet për pagesë të financohen nga fondet e planifikuara të vitit 2013, sipas pagesave të percaktuara në këtë vendim.

V. Në komisionin e vlerësimit të projekteve për skemat mbështetëse të pemëtarisë do të marrë pjesë një përfaqësues i pushtetit vendor.

VI. Kriteret për të përfituar mbështetje, procedurat e aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe pagesës:

1. Për mbjellje ullishtesh, në vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe në vlerën 180,000 (njqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale.

1.1. Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Ngritja e ullishtes të bëhet në zona të studiuara në përputhje me studimin “Gjëndja aktuale e ullishtarisë dhe perspektiva e zhvillimit të saj”;
- c) Në qarkun e Vlorës, Gjirokastrës dhe rrethin e Mallakstrës do të financohet vetëm mbjellja e kultivarit “Kalinjot” në masën 100% të fondit në dispozicion të mbjelljes së ullirit për këto qarqe dhe rrethe;
- d) Në komunat Sinjë, Cukalat dhe Urë Vajgirore të rrethi Berat si dhe në komunën Cakran të rrethit të Fierit do të financohet vetëm mbjellja e kultivarit “Kalinjot”;
- e) Në qarqet, rrethet dhe komunat e mësipërme do të financohen për mbjellje fidanat e kultivarit “Kalinjot” të prodhuara vetëm në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë;
- f) Në qarqet, rrethet dhe komunat e tjera të vendit struktura varietore do të jenë në përputhje me studimin e cituar në pikën (b), sipas Aneksit nr 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- g) Fidanët që do të përdoren për mbjelljen të jenë të certifikuar;
- h) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 20 vjet;
- i) Mbajllja mund të bëhet në zërin kadastral tokë bujqësore/kullotë/pyll/livadh. Në çdo rast të sipërcituar sipërfaqja e mbjellë duhet të jetë e shpyllëzuar nga shkurret dhe drurët pyjorë;
- j) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 2 dynym;
- k) Aplikanti mund të bëjë më shumë se një aplikim (kur toka nuk ndodhet në të njëjtin vend ose zbaton forma të ndryshme kultivimi), por sipërfaqja maksimale për çdo aplikant nuk duhet të jetë më shumë se 5 ha për format ekstensive dhe jo më shumë se 10 ha për format intensive të kultivimit;
- l) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin Nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- m) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- n) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

1.2. Kriteret konkurruese

1. Statusi i aplikantit	15
2. Shtim i sipërfaqes në bllok për specien që aplikon	15
3. Sipërfaqja e tokës që do të mbillet	45
4. Sistemimi/punimi i tokës	25
a. Sistemimi/punimi i tokës	15
b. Masat antierozive/kulluse	5
c. Mënyra e ujitjes (Ujitja me pika)	5

TOTALI**100**

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

2. Për mbjellje arrash, në vlerën 250,000 (dyqind e pesedhjetë mijë) leke/ha për mbjelljet me fidanë të shartuar, dhe në vlerën 180,000 (njqind e tetedhjetë mijë) lekë/ha, për mbjelljet me fidanë të pashartuar në të gjithë vendin.

2.1. Kriteret e përfitimit

- o) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- a) Ngritja e arroveve të bëhet në zona të studiuara në përputhje me studimin kombëtar “ Mbi gjëndjen dhe perspektivën e zhvillimit të drurëve arrorë (arra, gështenja, lajthi, bajame) dhe shegës në Shqipëri” dhe Aneksin Nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- b) Fidanët që do të përdoren për mbjelljen të jenë të certifikuar;
- c) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 20 vjet;
- d) Mbjetlla mund të bëhet në zërin kadastral tokë bujqësore/kullotë/pyll/livadh. Në çdo rast të sipërcituar sipërfaqja e mbjetllë duhet të jetë e shpyllëzuar nga shkurret dhe drurët pyjorë;
- e) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 2 dynym;
- f) Aplikanti mund të bëjë më shumë se një aplikim (kur toka nuk ndodhet në të njëjtin vend ose zbaton forma të ndryshme kultivimi), por sipërfaqja maksimale për çdo aplikant nuk duhet të jetë më shumë se 5 ha;
- g) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin Nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.
- h) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- i) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

2.2. Kriteret konkurruese

1. Statusi i alikantit	15
2. Fidani i përdorur për mbjetlle	15
3. Sipërfaqja e tokës që do të mbillet	45
4. Teknika e projektuar per ngritjen e arroveve	25
a. Shpyllëzim	5
b. Sistemimi/punimi i tokes	15
c. Masat antierozive/kulluse	5

TOTALI**100**

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

3. Për mbjellje ekstensive lajthish dhe shegësh, në vlerën 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha.

3.1. Kriteret e përfitimit

- a) Statusi i përfituesve të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- a) Ngritja e lajthishteve dhe pemtoreve me shegë të bëhet në zona të studiuara në përputhje me studimin kombëtar “ Mbi gjëndjen dhe perspektivën e zhvillimit të drurëve arrorë (arra, gështenja, lajthi, bajame) dhe shegës në Shqipëri” dhe Aneksin nr 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- b) Fidanët që do të përdoren për mbjelljen të jenë të certifikuar;
- c) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 20 vjet;
- d) Mbjetllja mund të bëhet në zërin kadastral tokë bujqësore/kullotë/pyll/livadh. Në çdo rast të sipërcituar sipërfaqja e mbjetllë duhet të jetë e shpyllëzuar nga shkurret dhe drurët pyjorë;
- e) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 2 dynym.
- f) Aplikanti mund të bëjë më shumë se një aplikim (kur toka nuk ndodhet në të njëjtin vend), por sipërfaqja maksimale për çdo aplikant nuk duhet të jetë më shumë se 5 ha.
- g) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin Nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.
- h) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- i) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

3.2. Kriteret konkurruese

1. Statusi i alikantit	15
2. Shtim i sipërfaqes në bllok për specien që aplikon	15
3. Sipërfaqja e tokës që do të mbillet	45
4. Teknika e projektuar per ngritjen e lajthishtes/pemtores me shegë	25
a. Shpyllëzim	5
b. Sistemimi/punimi i tokës	15
c. Masat antierozive/kulluse	5
TOTALI	100

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

4. Për mbjellje intensive lajthish dhe shegësh, në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha.

4.1. Kriteret e përfitimit

- a) Statusi i përfituesve të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Ngritja e lajthishteve dhe pemtoreve me shegë të bëhet në zona të studiuara në përputhje me studimin kombëtar “ Mbi gjëndjen dhe perspektivën e zhvillimit të drurëve arrorë (arra, gështenja, lajthi, bajame) dhe shegës në Shqipëri” dhe Aneksin nr 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- c) Fidanët që do të përdoren për mbjelljen të jenë të certifikuar;
- d) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 20 vjet;
- e) Mbjellja mund të bëhet në zërin kadastral tokë bujësore/kullotë/pyll/livadh. Në çdo rast të sipërcituar sipërfaqja e mbjellë duhet të jetë e shpyllëzuar nga shkurret dhe drurët pyjorë;
- f) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 2 dynym;
- g) Aplikanti mund të bëjë më shumë se një aplikim (kur toka nuk ndodhet në të njëjtin vend ose kultivon specie të ndryshme), por sipërfaqja maksimale për çdo aplikant nuk duhet të jetë më shumë se 10 ha;
- h) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin Nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- i) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- j) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

4.2. Kriteret konkurruese

1. Statusi i aplikantit	15
2. Shtim sipërfaqe për specien që aplikon	15
3. Shtim i sipërfaqes në bllok për specien që aplikon	45
4. Teknika e projektuar për ngritjen e lajthishtes/pemtores me shegë	25
a. Sistemimi/punimi i tokës	15
b. Masat antierozive/kulluse	5
c. Mënyra e ujitjes (Ujitja me pika)	5
TOTALI	100

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

5. Për mbjellje mollësh, dardhash, kumbullash, qershish, pjeshkësh dhe ftonjsh në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha.

5.1. Kriteret e përfitimit

- a) Statusi i përfituesve të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Ngritja e pemtoreve të bëhet në zona të studiuara në përputhje me rajonizimin e tyre të përcaktuara për secilën specie dhe qark në Aneksin nr 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- c) Fidanët që do të përdoren për mbjelljen të jenë të certifikuar;
- d) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 20 vjet;
- e) Mbjetllja mund të bëhet në zërin kadastral tokë bujqësore/kullotë/pyll/livadh. Në çdo rast të sipërcituar sipërfaqja e mbjetllë duhet të jetë e shpyllëzuar nga shkurret dhe drurët pyjorë;
- f) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 2 dynym;
- g) Aplikanti mund të bëjë më shumë se një aplikim (kur toka nuk ndodhet në të njëjtin vend, kultivon specie të ndryshme apo zbaton forma të ndryshme kultivimi), por sipërfaqja maksimale për çdo aplikant nuk duhet të jetë më shumë se 5 ha;
- h) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin Nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- i) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- j) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

5.2. Kriteret konkurruese

1. Statusi i aplikantit	15
2. Shtim i sipërfaqes në bllok për specien që aplikon	15
3. Sipërfaqja e tokës që do të mbillet	45
4. Teknika e projektuar për ngritjen e pemtores	25
a. Sistemimi/punimi i tokës	15
b. Masat antierozive/kulluse	5
c. Menyra e kultivimit (Intensive)	5
TOTALI	100

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

6. Për mbjellje agrumesh, kivi dhe luleshtrydesh, në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit;

6.1. Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Ngritja e agrumishteve, ngastrave me kivi dhe luleshtrydhe të bëhet në zona të studiuara në përputhje me rajonizimin e tyre të përcaktuara për secilën specie dhe qark në Aneksin nr 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- c) Fidanët që do të përdoren për mbjelljen të jenë të certifikuar;
- d) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 20 vjet;
- e) Mbjellja mund të bëhet në zërin kadastral tokë bujqësore/kullotë/pyll/livadh. Në çdo rast të sipërcituar sipërfaqja e mbjellë duhet të jetë e shpyllëzuar nga shkurret dhe drurët pyjorë.
- f) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 2 dynym.
- g) Aplikanti mund të bëjë më shumë se një aplikim (kur toka nuk ndodhet në të njëjtin vend apo kultivon specie të ndryshme), por sipërfaqja maksimale për çdo aplikant nuk duhet të jetë më shumë se 10 ha.
- h) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin Nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.
- i) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- j) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

6.2. Kriteret konkurruese

1. Statusi i aplikantit	15
2. Shtim i sipërfaqes në bllok për specien që aplikon	15
3. Sipërfaqja e tokës që do të mbillet	45
4. Teknika e projektuar për ngritjen e pemtores	25
a. Sistemimi/punimi i tokës	15
b. Masat antierozive/kulluse	5
c. Menyra e ujitjes (Ujitje me pika)	5

TOTALI **100**

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Paga e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

7. Për mbjelljen e vreshtave, në vlerën 250,000 (dyqind e pesedhjetë) mijë lekë/ha.

7.1. Kriteret e përfitimit

- a) Statusi i përfituesve të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Ngritja e vreshtave të bëhet në zona të studiuara në përputhje me rajonizimin e varieteteve të përcaktuara për secilin qark në Aneksin nr 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- c) Fidanët që do të përdoren për mbjelljen të jenë të certifikuar;
- d) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 20 vjet;
- e) Mbjellja mund të bëhet në zërin kadastral tokë bujësore/kullotë/pyll/livadh. Në çdo rast të sipërcituar sipërfaqja e mbjellë duhet të jetë e shpyllëzuar nga shkurret dhe drurët pyjorë;
- f) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 2 dynym;
- g) Aplikanti mund të bëjë më shumë se një aplikim (kur toka nuk ndodhet në të njëjtin vend), por sipërfaqja maksimale për çdo aplikant nuk duhet të jetë më shumë se 5 ha;
- h) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin Nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- i) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- j) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

7.2. Kriteret konkurruese

1. Statusi i aplikantit	15
2. Shtim i sipërfaqes në bllok për specien që aplikon	15
3. Sipërfaqja e tokës që do të mbillet	45
4. Teknika e projektuar për ngritjen e sistemit vadites	25
a. Sistemimi/punimi i tokës	15
b. Masat antierozive/kulluse	5
c. Sistemi ujitjes me pika	5

TOTALI **100**

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

PROCEDURA QË DO TË NDIQET PËR SKEMAT E MBJELLJEVE TE REJA

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për masat e mbështetjes financiare 1-7, fillon më 10 Shkurt 2013 dhe përfundon më 31 Mars 2013.

Fermerët individuale, subjekte dhe SHBB aplikojnë për të përfituar mbështetje financiare para fillimit të punës për ngritjen e ngastrës, bllokut apo masivit të ullishtës/pemtoreve/vreshtave/agrumëve etj.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë të rrethit përkatës sipas formularit të aplikimit (Formulari 1/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Projekti (Sipas Formularit. ½).
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.
- Dokument që vërteton statusin e aplikantit (emigrant, subjekt, Shoqëri Bashkëpunimit Bujqësor)
- Dokumenti i pronësisë së tokës.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentat e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP)
- Akti i pronësisë së tokës (Sipas ligjit 7501).
- Vërtetim pronësie nga Komuna/Bashkia në rastet kur nuk ka përfunduar shpërndarja e titujve të pronësisë, të lëshuar nga specialisti i zyrës përkatëse të komunës/Bashkisë sipas formularit bashkëngjitur udhëzimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me komunat (Kontratë tip)
- Kontratë qiraje me individë

Kontrata e qirasë në të dyja rastet për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të jetë e noterizuar. Në rastet kur nuk ka përfunduar azhurnimi i tokës bujqësore të përdoret kontrata tip.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 1/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 1/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje të formularit 1/3 i jepet aplikantit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brënda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (Formulari 1/4).

DRBU grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kriterëve të konkurueshmërisë të skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 6 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR qendër - anëtar.
5. Përfaqësuesi i komunës/bashkisë përkatëse (specialist bujqësie) - anëtar

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 1/5). Formulari i vlerësimit (Formulari 1/5), duhet të jetë i firmosur nga jo më pak se 5 anëtarë të komisionit.

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual.
- b. Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- c. Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtese.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007 i ndryshuar, MPÇSSHB).

Në lidhje me kriterin e shtimit të sipërfaqes ekzistuese fiton 15 pikë aplikanti që ka një sipërfaqe ekzistuese me të njëjtën specie me sipërfaqen që aplikon mbi 2 ha, 10 pikë kur sipërfaqja ekzistuese është nga 1-2 ha dhe 5 pikë aplikimi që ka deri në 1 ha sipërfaqe ekzistuese.

Vlerësimi maksimal për sipërfaqen e fiton aplikanti me sipërfaqen maksimale të aplikueshme, të tjerët vlerësohen në përpjestim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vënde publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitim të mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 1/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 1/7).

Të dy formularët (1/6 dhe 1/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

c. Rregjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të të gjitha aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

d. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Kushti i domosdoshëm për të përfutur mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është ndërtimi i ullishteve/arrore/pemtoreve/subtropikaleve/vreshtave sipas projektit për të cilën fermeri ka aplikuar dhe është vlerësuar.

Menjëherë pas përfundimit të punës për ngritjen e ullishteve/arrore/pemtoreve/subtropikaleve/vreshtave, fermeri njofton AZHBR në rajon. Kjo e fundit dërgon Grupin e Verifikimit të Projekteve për verifikimin në vënd të realizimit të projektit duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (Formulari 1/8). Nga ballafaqimi i faktit me udhëzimin dhe parametrat e projektit në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me projektin e miratuar dhe kriteret e përfitueshmërisë.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturën tatimore të blerjes së fidanave ku specifikohet sasia e fidanëve të blerë.
- Një kopje të certifikatës së garancisë së materialit mbjellës (fidanit), ku të jetë shënuar specia dhe varieteti, me vulën origjinale (të njomë).
- Vërtetim nga Komuna/Bashkia dhe mandat arkëtimi përkatës, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2013.
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brënda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 1/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 1/9 dhe 1/9/a).

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR-ja aplikon penalitete si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton më i vogël se 10% aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar.
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10% aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike.

Në rast se nga zbatimi faktik i projektit, numri i bimëve nuk i përgjigjet formës së kultivimit për të cilën aplikimi është vlerësuar, pagesa bëhet për formën faktike të aplikimit në raport me numrin e bimëve të mbjella, duke e penalizuar përfituesin edhe me zbritjen e vlerës së financuar në masën 5% të vlerës së projektit.

AZHBR-ja duhet të bëjë ballafaqimin e të dhënave të marra nga certifikata e garancisë së materialit mbjellës me ato të buletinit të certifikimit që publikohet çdo muaj nga ESHFF.

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

Xhirimi i parave për këto masa mbështetëse do të bëhet në dy këste: 70% të vlerës së projektit financohet pas verifikimit të parë dhe 30 % të vlerës së projektit bëhet gjatë muajve Tetor/Nëntor 2013.

Pas financimit të kështit të parë dhe para financimit të dytë (30% i vlerës së financimit), AZHBR-ja rikontrollon jo më pak se 10% të projekteve të financuara. Rikontrolli i projekteve nuk do të bëhet nga i njëjti ekip që ka realizuar verifikimin e parë.

Gjatë kontrollit pas financimit grupi i kontrollit krahas ballafaqimit të rezultateve të verifikimit para financimit me faktin do të verifikojë edhe përqindjen e zënies së fidanave, zhvillimin i tyre dhe nivelin e shërbimeve agroteknike (Formulari 1/8/a).

Nëse investimi i rikontrolluar ka probleme si rezultat i mungesës së shërbimeve agroteknike, si infeksione të larta nga barërat e këqia, përqindje të fidanave të dëmtuar mbi 10%, aplikantëve

nuk do t'u financohet kësti i dytë i investimit. Nëse përqindja e tharjeve është deri në 10%, fermerëve u lihet detyrë të bëjnë menjëherë zëvendësimin e fidanave të dëmtuar.

Nëse në projektet e kontrolluara pas financimit ka ndryshime të parametrave sasiore të cilat ndikojnë në vlerën financiare që përfituesi ka përfituar padrejtësisht, AZHBR-ja qendër bën rikalkulimet dhe propozon masat ndëshkuese përkatëse.

8. Për ujitjen me pika në aroret, lajthitë, bajamet e shegën, pemtoret, agrumishtet, ullishtet (vetëm për format intensive të kultivimit të tyre), dhe serrat me ngrohje diellore dhe teknike, në vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë), lekë/ha.

8.2. Kriteret e përfitimit

- a) Përfituesit e kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
 - Grup fermerësh;
- b) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 20 vjet;
- c) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 5 dynym dhe jo më e madhe se 10 ha;
- d) Për fermerët që aplikojnë në grup toka të jetë një parcelë/bllok ose masiv;
- e) Aplikanti mund të bëjë një aplikim për të njëjtën specie, për specie të ndryshme, por toka për të cilën aplikohet të jetë një parcelë, bllok ose masiv dhe mënyra e kultivimit intensive;
- f) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin Nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- g) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- h) Përfituesi të ketë bërë "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

8.3. Kriteret konkurruese

1. Statusi i aplikantit	15
2. Sipërfaqja e tokës që do të mbillet	45
3. Specie/Speciet	10
4. Teknika e projektuar për ujitjen	20
5. Fermat BIO	10
TOTALI	100

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Paga e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

8.4. Procedura që do të ndiqet për skemën e ujitjes me pika

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare të skemës së ujitjes me pika fillon më 15 Mars 2013 dhe përfundon më 30 Prill 2013.

Fermerët individuale/subjektet/shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor apo grupet e fermerëve aplikojnë për të përfituar mbështetje financiare para fillimit të punës për instalimin e sistemit të ujitjes me pika.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë në rreth sipas formularit të aplikimit (Formulari 8/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Projekti (Sipas Formularit. 8/2).
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.
- Dokument që vërteton statusin e aplikantit (emigrant, subjekt, Shoqëri Bashkëpunimit Bujqësor)
- Kontratë e posaçme (e noterizuar) për fermerët që aplikojnë në grup.
- Çertifikatën BIO ose në kalim (konvertim), lëshuar nga organizmi çertifikues për produktin/produktet e fermës së tij.
- Dokumenti i pronësisë së tokës.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentat e mëposhtëm:

- Çertifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP)
- Akti i pronësisë së tokës (Sipas ligjit 7501).
- Vërtetim pronësie nga Komuna/Bashkia në rastet kur nuk ka përfunduar shpërndarja e titujve të pronësisë, të lëshuar nga specialisti i zyrës përkatëse të komunës/Bashkisë sipas formularit bashkëngjitur udhëzimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me komunat (Kontratë tip)
- Kontratë qiraje me individë

Kontrata e qirasë në të dyja rastet për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të jetë e noterizuar. Në rastet kur nuk ka përfunduar azhurnimi i tokës bujqësore të përdoret kontrata tip.

Për grupet e fermerëve aplikanti plotëson dosjen e aplikimit me të gjithë dokumentacionin përkatës të njëjta si për fermerët individualë me përjashtim të projektit që do të jetë i përbashkët. Grupet caktojnë me prokurë personin përgjegjës për të aplikuar dhe ndjekur të gjitha procedurat e implementimit të projektit të aplikuar.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 8/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 8/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje të formularit 8/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brënda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili i duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brënda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brënda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e aplikimit për rrethin (Formulari 8/4).

DRB grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

5. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kriterëve të konkurueshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brënda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 8/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual.
- b. Subjekte me status fizik/ juridik dhe grup fermerësh 10 pikë.
- c. Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPÇSSHB).

Vlerësimi maksimal për specien/grup speciet do ta marrin speciet/ grup speciet më prioritare në raport me speciet/grup speciet e përcaktuara në një zonë të caktuar sipas rajonizimit. Secili qark do të bëjë një klasifikim të specieve/grup specieve sipas rendësisë dhe vlerës ekonomike që kanë kulturat për qarkun dhe kërkesave të këtyre të fundit për ujë.

Vlerësimi maksimal për sipërfaqen e fiton aplikuesi me sipërfaqen maksimale të aplikueshme, të tjerët vlerësohen në përpjestim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

Që të përfitojë pikët në lidhje me produktin BIO aplikanti duhet të paraqesë në momentin e aplikimit çertifikatën BIO ose në kalim (konvertim), të lëshuar nga organizmi çertifikues për produktin/produktet e fermës së tij.

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë dhe rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyra të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vënde publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 8/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 8/7).

Të dy formularët (8/6 dhe 8/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

6. Rregjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

7. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është instalimi dhe vënia në funksionim të sistemit të ujitjes me pika sipas projektit për të cilën fermeri ka aplikuar dhe është vlerësuar.

Menjëherë pas përfundimit të punës për instalimin e sistemit të ujitjes me pika fermeri njofton AZHBR në rajon. Kjo e fundit dërgon Grupin e Verifikimit të Projekteve për verifikimin në vend të realizimit të projektit duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (Formulari 8/8). Nga ballafaqimi i

faktit me kriteret e përfitueshmërisë dhe parametrat e projektit në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturat tatimore të blerjes së materialeve të përdorura për instalimin e sistemit të ujitjes me pika.
- Vërtetim nga Komuna/Bashkia dhe mandat arkëtimi përkatës, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2013.
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 8/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 8/9 dhe 8/9/a).

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton më i vogël se 10% aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar.
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10% aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike.

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse.

Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

9. Për prodhimin e vajit të ullirit extra i virgjër, në vlerën 100 (njëqind) lekë/litrë, për sasitë e prodhimit deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ton/vit.

9.1. Kriteret e përfitimit

- a) Përfitojnë subjektet fizike/juridike që merren me prodhimin e vajit të ullirit extra-vergine dhe që janë të regjistruara për këtë destinacion në organet tatimore;
- b) Përfitojnë ata prodhues që sigurojnë ruajtjen e prodhimit në tanker inox;
- c) Mbështet vetëm prodhimi i vajit të ullirit extra-vergine që plotëson standartet teknike sipas formularit 9/2;
- d) Pagesa bëhet mbi bazën e faturave tatimore të shitjes së vajit, të dorëzuara në AZHBR;
- e) Sasia maksimale për pagesë është 15 ton vaj extra vergine brenda vitit 2013;
- f) Përfitojnë ata përpunues që përdorin si lëndë të parë ullirin e prodhuar në vend;
- g) Prodhuesi duhet të vërtetojë me dokumentacion (flete hyrje) burimin e lëndës së parë;
- h) Të ketë bërë "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

9.2. Procedura që do të ndiqet

a) Aplikimi

Aplikimi për mbështetjen financiare për këtë skemë mbështetëse bëhet në dy faza: Faza e parë: 10 Shkurt – 28 Shkurt 2013 dhe Faza e dytë: 1 Tetor – 10 Nëntor 2013

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqesise në rreth sipas formularit të aplikimit (Formulari 9/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a. Dokumentin e regjistrimit në tatim - taksa.
- b. Dokument nga zyra e tatimeve që vërteton se subjekti nuk ka detyrime tatimore
- c. Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- d. Vërtetim banke për numrin e llogarisë.
- e. Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet në Zyrën e Bujqësisë së rrethit e cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimeve së bashku me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimit (Formulari 9/3).

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve tek Drejtori i DRB-së, i cili i duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqesise së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (Formulari 9/4).

DRB-të bëjnë regjistrimin e aplikantëve në regjistrin e qarkut duke ruajtur renditjen e mësipërm (Formulari 9/5), si dhe bën njëkohësisht transferimin e dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR rajonale.

Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së aplikimeve në Regjistrin e Aplikantëve të qarkut. Për ç' do dosje të dorëzuar plotësohet formulari i dorëzimit të dosjes (Formulari 9/6).

Të dy formularët (9/5 dhe 9/6), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në rolin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në rolin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

b) Regjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

c) Verifikimi dhe pagesa

Me marrjen e dosjeve të aplikantëve, grupi i verifikimit brënda 10 ditëve bën identifikimin e sasisë dhe marrjen e mostrave të vajit extra vergine për analizë.

“Grupi i verifikimit është i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB. Grupi i verifikimit kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Marrja e mostrave bëhet për çdo çistern të deklaruar. Mënyra e marrjes së mostrës dhe të dhënat që e shoqërojnë atë janë ato të procedurave standarte të mostrimit për analiza laboratorike. Mostra duhet të jetë e koduar dhe pa emër subjekti. Me marrjen e mostrave për çdo subjekt grupi i verifikimit plotëson formularin 9/7.

Për marrjen e mostrës grupi i verifikimit asistohet edhe nga përfaqësues të AZHBR qendër. Përfaqësuesit e AZHBR-së bëjnë dërgimin e mostrës për analizë në laboratorin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV) në Tiranë. Shpenzimet për kryerjen e analizave laboratorike të mostrave të vajit përballohen nga aplikuesi (prodhuesi i vajit). Pagesa bëhet 15 ditë pas marrjes së përgjigjes së analizave nga AZHBR.

Treguesit e vajit pasqyrohen në fletë analizën e lëshuar nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV).

Pas përfundimit të analizave dhe daljes së rezultatit, AZHBR njofton aplikuesin për rezultatin e analizës. Aplikuesi, vaji i të cilit rezulton me karakteristika në përputhje me formularin 9/2 do të përfitojë mbështetjen e parashikuar vetëm pas shitjes së vajit extra vergine të evidentuar me faturat tatimore të shitjes.

Me të përfunduar shitjen aplikanti bën një kërkesë në AZHBR për sasinë e mbështetjes që kërkon në përputhje me faturat e shitjes por brënda sasisë së kushtëzuar në kriteret e përfitueshmërisë. Brënda 15 ditëve nga marrja e kërkesës AZHBR është e detyruar të dërgojë përsëri grupin e verifikimit i cili bën verifikimin në vënd të gjëndjes fizike të vajit si dhe faturat e shitjes. Në përfundim të verifikimit plotësohet formulari i kontrollit para pagesës (Formulari 9/8)

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë ekipi i verifikimit të projekteve.

Grupi i verifikimit brënda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacioni origjinal), së bashku me formularin e kontrollit (Formulari 9/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të aplikimit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 9/9 dhe 9/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrolli të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

10. Për prodhimin e produkteve organike bujqësore nga bimët e kultivuara në vlerën 70,000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/fermë;

10.1 Kriteret e përfitimit

- a) Përfitojnë të gjithë ata fermerë që kanë ferma të certifikuara për prodhim BIO, me kusht që sipërfaqja e një specie të mos jetë më e vogël se 0.5 ha.
- b) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 5 vjet;
- c) Të kenë kontratë me subjektet tregtuese dhe agropërpunues për produktin e certifikuar.
- d) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- e) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

10.2 Proçedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 01 Prill deri 30 Shtator 2013

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR sipas formularit të aplikimit (Formulari 10/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i me poshtëm poshtëm:

- Formulari me të dhënat kryesore të fermës (Formulari 10/2).
- Çertifikatën BIO ose në kalim (konvertim), të lëshuar nga organizmi certifikues për produktin/produktet e fermës së tij.
- Kontratë e noterizuar me subjekte tregtues ose agropërpunues për produktin e certifikuar në të cilën shënohet që “Produkti është BIO”.
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.
- Dokumenti i pronësisë së tokës.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentat e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP)
- Akti i pronësisë së tokës (Sipas ligjit 7501).
- Vërtetim pronësie nga Komuna/Bashkia në rastet kur nuk ka përfunduar shpërndarja e titujve të pronësisë, të lëshuar nga specialisti i zyrës përkatëse të komunës/Bashkisë sipas formularit bashkëngjitur udhëzimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me komunat (Kontratë tip)
- Kontratë qiraje me individë

Kontrata e qirasë në të dyja rastet për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të jetë e noterizuar. Në rastet kur nuk ka përfunduar azhurnimi i tokës bujqësore të përdoret kontrata tip.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimit (Formulari 10/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (Formulari 10/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimit. Një kopje të formularit 10/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brënda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brënda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (Formulari 10/4).

DRBU grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

Një kopje e listave të aplikantëve te renditur sipas parimit “kush vjen i pari renditet i pari”, me firmë dhe vulë të njomë të DRBU-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Me marrjen e të gjithë listave dhe dokumentacionit DRB-të bëjnë transferimin e dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR rajonale sipas formularit 10/7.

Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në regjistrin e aplikantëve të rrethit. Për çdo dosje të dorëzuar plotësohet formulari i dorëzimit të dosjes (Formulari 10/6).

Të dy formularët (10/6 dhe 10/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në rolin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në rolin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR - së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

b. Regjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base e të gjithë aplikimeve sipas listave të DRB-ve. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

c. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve sipas rradhës “Kush vjen i pari renditet i pari”, dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR rajonale organizon verifikimin në terren të aplikimeve që kanë fituar të drejtën e financimit.

Verifikimi i produkteve BIO bëhet gjatë muajit Tetor 2013.

Për verifikimin e fermave BIO dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i Verifikimit të Projekteve”, i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij bën verifikimin në vënd të fermës dhe plotëson formularin e verifikimit (Formulari 10/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë si dhe me të dhënat e deklaruara në formularin 10/2, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse aplikimi është në përputhje me udhëzimin.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë ekipi i verifikimit të projekteve. Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Komuna/Bashkia dhe mandat arkëtimi përkatës, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2013.
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brënda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 10/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 10/9 dhe 10/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse.

AZHBR – ja duhet të bëjë verifikimin e çertifikatës të lëshuar nga organizmat çertifikues KSHPO.

Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër nëpërmjet një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

11. Për blerjen ose zëvendësimin e plastmasit për serrat me ngrohje diellore dhe teknike (në shkallë vendi), në vlerën 400,000 (katërqind mijë) lekë/ha. Sipërfaqja minimale të jetë 2 (dy) dynmë.

11.1 Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Fermerët që kanë serra me ngrohje diellore dhe teknike me plastmas me destinacion prodhimin e perimeve;
- c) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 6 vjet nga moment i aplikimit;
- d) Sipërfaqja minimale e serrës për t'u mbështetur për financim është 2 dyn;
- e) Aplikanti që përfiton financim për këtë masë mbështetje nuk mund të aplikojë përsëri për të njëjtën sipërfaqe serre të paktën për 3 vjet;
- f) Plastmasi i blerë të jetë cilësor i tipit *long life* dhe trashësia të jetë jo më pak se 180-220 mikron, parametra që vërtetohen nga certifikata e garancisë;
- g) Në momentin e verifikimit serra të jetë e kultivuar;
- h) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- i) Përfituesi të ketë bërë "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

11.2 Kriteret konkurruese

a. Rajonizimi	10 pikë
b. Sipërfaqja e serrës	40 pikë
c. Tipi i serrës	30 pikë
d. Prodhim BIO	5 pikë
e. Statusi i aplikantit (emigrant i kthyer, Shoqëri Bashkëpunimi Bujqësor apo organizatë prodhuesish)	15 pikë

TOTALI

100

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

11.3 Procedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 15 Shkurt – 31 Mars 2013 për mbjelljet e para (domate, trangull, spec, patilixhan, pjepër), dhe të dyta (domate, trangull, pjepër).

Fermerët individuale, subjekte apo SHBB aplikojnë për të përfituar mbështetje financiare para fillimit të punës për vendosjen e plasmasit.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë në rreth sipas formularit të aplikimit (Formulari 11/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Projekti (Sipas Formularit. 11/2);
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit;
- Çertifikatën BIO ose në kalim (konvertim), të lëshuar nga organizmi çertifikues për produktin/produktet e fermës së tij;
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë;
- Dokument që vërteton statusin e aplikantit (emigrant, subjekt, SHBB);
- Dokumenti i pronësisë së tokës.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentat e mëposhtëm:

- Çertifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP)
- Akti i pronësisë së tokës (Sipas ligjit 7501).
- Vërtetim pronësie nga Komuna/Bashkia në rastet kur nuk ka përfunduar shpërndarja e titujve të pronësisë, të lëshuar nga specialisti i zyrës përkatëse të komunës/Bashkisë sipas formularit bashkëngjitur udhëzimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me komunat (Kontratë tip)
- Kontratë qiraje me individë

Kontrata e qirasë në të dyja rastet për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të jetë e noterizuar. Në rastet kur nuk ka përfunduar azhurnimi i tokës bujqësore të përdoret kontrata tip.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 11/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 11/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje e formularit 11/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brënda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brënda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brënda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB-se qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 11/4).

DRB grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kriterëve të konkureshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brënda 10 ditëve pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 11/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual.
- b. Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- c. Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPÇSSHB.

Përsa i përket vlerësimit për rajonizimin prioritet kanë zonat fushore në Lushnjë, Berat, Fier, Elbasan, Durrës dhe Tiranë si dhe serrat që ndodhen në zona të tjera por që përmbushin kushtet klimatike, teknike dhe afërsinë me tregjet.

Vlerësimi maksimal për sipërfaqen e fiton aplikuesi me sipërfaqe më të madhe, të tjerët vlerësohen në përpjestim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

Vlerësimin maksimal për tipin e serrës e marrin serrat me konstruksion metalik (xingato);

Që të përfitojë pikët në lidhje me produktin BIO aplikanti duhet të paraqesë në momentin e aplikimit çertifikatën BIO ose në kalim (konvertim), të lëshuar nga organizmi certifikues për produktin/produktet e fermës së tij.

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë dhe rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vënde publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuar dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 11/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 11/7).

Të dy formularët (11/6 dhe 11/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRBUMK në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

c. Rregjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuar. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

d. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është vendosja e plasmasit dhe mbjellja e serrës me speciet e sipërpermëndura.

Menjëherë pas përfundimit të punës për vendosjen e plasmasit dhe mbjelljen e serrës fermeri njofton AZHBR në rajon. Kjo e fundit dërgon Grupin e Verifikimit të Projekteve për verifikimin në vënd të realizimit të projektit duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (Formulari 11/8). Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë dhe parametrat e projektit në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturen tatimore të blerjes së plastmasit;
- Një kopje të certifikatës së cilësisë/garancisë së plastmasit me vulën origjinale të shitësit (të njomë);
- Vërtetim nga Komuna/Bashkia dhe mandat arkëtimi përkatës, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2013;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brënda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 11/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 11/9 dhe 11/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton më i vogël se 10% aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar.
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10% aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

12. Për blerjen e plastmasit për prodhimin e bostanoreve në tunele, në vlerën 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë), lekë/ha, për fermerët që mbjellin jo më pak se 5 (pesë) dynym bostanore.

12.1. Kriteret e përfitimit

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;

b) Përfitojnë të gjithë fermerët që kanë mbjellë bostanore (pjepër dhe shalqin) në tunele plastike;

c) Madhësia e sipërfaqes së mbjelle me tunele plastik jo më pak se 0.5 ha;

d) Toka të jetë në pronësi, përdorim ose me qira për të paktën 1 vit nga momenti i aplikimit;

- e) Tunelet duhet të jenë kultivuar (në momentin e verifikimit). Kjo vërtetohet gjatë fazës së verifikimit në terren dhe numri i bimëve/ha të jetë sipas Aneksit Nr 2 bashkëngjitur këtij udhëzimi.
- f) Skema zbatohet për Qarqet Fier, Berat, Durrës dhe rrethet e Sarandës dhe Kavajës.
- g) Aplikanti të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- h) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

12.2. Kriteret konkurruese	Pikë
a. Rajonizimi	20
b. Sipërfaqja e mbjelle me tunel	45
c. Tipi i tunelit (Harqe metalike)	20
d. Statusi i aplikantit	15
TOTALI	100

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

12.3. Proçedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 10 Shkurt deri 31 Mars 2013

Fermerët individuale apo subjektet aplikojnë për të përfutur mbështetje financiare para fillimit të punës për vendosjen e plasmasit.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë në rreth sipas formularit të aplikimit (Formulari 12/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Projekti (Sipas Formularit. 12/2);
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit;
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë;
- Dokument që vërteton statusin e aplikantit (emigrant, subjekt, organizatë);
- Dokumenti i pronësisë së tokës.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentat e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP)
- Akti i pronësisë së tokës (Sipas ligjit 7501).
- Vërtetim pronësie nga Komuna/Bashkia në rastet kur nuk ka përfunduar shpërndarja e titujve të pronësisë, të lëshuar nga specialisti i zyrës përkatëse të komunës/Bashkisë sipas formularit bashkëngjitur udhëzimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me komunitat (Kontratë tip)
- Kontratë qiraje me individë

Kontrata e qirasë në të dyja rastet për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore, duhet të jetë e noterizuar. Në rastet kur nuk ka përfunduar azhurnimi i tokës bujqësore të përdoret kontrata tip.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimit (Formulari 12/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (Formulari 12/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimit. Një kopje të formularit 12/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve tek Drejtori i DRB-së, i cili i duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e aplikimit për rrethin (Formulari 12/4).

DRB grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

d. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kriterëve të konkurueshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditëve pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 12/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual;
- b. Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë;
- c. Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë;
- d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë;

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të "Statusit të Emigrantit", lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPCSSHB).

Vlerësimi maksimal për sipërfaqen e fiton aplikuesi me sipërfaqe më të madhe të aplikuar të tjerët vlerësohen në përpjestim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

Vlerësimin maksimal e marrin tunelet me konstruksion metalik.

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë dhe rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vënde publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 12/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 12/7).

Të dy formularët (12/6 dhe 12/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

e. Rregjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

f. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është vendosja e plasmasit dhe tuneli të jetë i kultivuar.

Menjëherë pas përfundimit të punës për vendosjen e plasmasit dhe mbjelljen e tunelit fermeri njofton AZHBR në rajon. Kjo e fundit dërgon Grupin e Verifikimit të Projekteve për verifikimin në vënd të realizimit të projektit duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (Formulari 12/8). Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë dhe parametrat e projektit në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturen tatimore të blerjes së plastmasit;
- Vërtetim nga Komuna/Bashkia dhe mandat arkëtimi përkatës, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2013;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 11/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 12/9 dhe 12/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton më i vogël se 10% aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar.
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10% aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

13. Në vlerën 10 (dhjetë) lekë/litër qumësht, për fermat blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë qumështi të matrikulluara të racave të pastra

apo kryqëzimet e tyre, por financimi të bëhet për jo më shumë se 80 (tetëdhjetë) krerë. Pagesa të bëhet kundrejt sasive të qumështit, të deklaruar në organet tatimore.

13.1. Kriteret e përfitimit

- d) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
- Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik.
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor.
- e) Ferma duhet të jetë e regjistruar si subjekt në organet tatimore;
- f) Përfitojnë ato ferma që kanë lopë të matrikuara dhe me regjim stallor;
- g) Ferma të jetë e pajisur me certifikatë veterinare për lopët që mbarështon;
- h) Përfitojnë fermat me jo më pak se 10 krerë lopë qumështi të matrikuara;
- i) Pagesa kryhet për jo më shumë se 80 krerë lopë qumështi të matrikuara dhe sasia maksimale e qumështit për të cilën bëhet financimi është 2,000 litra/kokë lopë;
- j) Të vërtetojë shitjen e prodhimit (/kontratë me subjekte përpunues, grumbullues, tregtues apo ent shtetëror);
- k) Pagesa kryhet kundrejt sasive të qumështit të deklaruar në organet tatimore;
- l) Të sigurojë ruajtjen e qumështit me tankera ftohës;
- m) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

13.2. Kriteret konkurruese

a. Numri i krerëve	30 pikë
b. Raca	20 pikë
c. Projekti i stallës	20 pikë
d. Mjelje e mekanizuar	10 pikë
e. Furnizimi me ujë të vazhdueshëm	5 pikë
f. Statusi i aplikantit (emigrant i kthyer, subjekt, SHBB	15 pikë

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

13.3. Procedura që do të ndiqet

a) Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 1 Maj 2012 dhe përfundon më 30 Qershor të 2012.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR sipas formularit të aplikimit (Formulari 13/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Projekti i stallës (Sipas Formularit 13/2);
- Fotokopje e regjistrimit në QKR;
- Kontratë me subjekte të licencuara për përpunim ose grumbullim qumështi;
- Regjistri i fermës së lopëve;
- Certifikata veterinare e tufës;
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit;
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimit (Formulari 13/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (Formulari 13/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimit. Një kopje të formularit 13/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brënda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brënda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brënda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (Formulari 13/4).

DRB grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b) Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kriterëve të konkurueshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR Qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brënda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 13/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual.
- b. Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- c. Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.

d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPÇSSHB).

Vlerësimi maksimal për numrin e krerëve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të lopëve të matrikulluara në nivel qarku, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me numrin më të madh të lopëve.

Përsa i përket racës pikët maksimale (20), i marrin fermat me lopë të racave të pastra me drejtim qumështi, 18 racat me drejtim qumësht - mish dhe 15 pikë lopët e kryqëzuara;

Vlerësimi për pikën c bëhet sipas pikëve që kanë elementët e stallës në aneksin 3, për projektet e stallës së lopëve, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Brenda 5 ditëve pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë dhe rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vënde publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 13/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 13/7).

Të dy formularët (13/6 dhe 13/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRBUMK në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brenda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

g. Rregjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

h. Verifikimi dhe pagesa

Verifikimi i fermës blegtorale të lopëve bëhet në periudhën 1 Gusht – 30 Tetor 2012.

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i Verifikimit të Projekteve”, i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohen nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij bën verifikimin në vend të lopëve sipas regjistrit të fermës dhe faktit, bën matjet dhe verifikimet e nevojshme të stallës dhe plotëson formularin e verifikimit (Formulari 13/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitimit si dhe me parametrat e stallës, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse gjendja faktike e fermës është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturën/Faturat tatimore të shitjes së qumështit.
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 13/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 13/9 dhe 13/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

14. Në vlerën 500 (pesëqind) lekë/krerë dele ose dhi të matrikulluara për fermerët, të cilët mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 300 (treqind) krerë.

14.1 Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik.
- Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor.
- b) Fermerë që kanë tufa homogjene me dele ose me dhi të matrikulluara;
- c) Madhësia e tufës sipas përcaktimeve të mësipërme jo më pak se 100 krerë dele ose dhi të matrikulluara;
- d) Pagesa të kryhet për jo më shumë se 300 krerë dele/dhi të matrikulluara.
- e) Tufat të jenë të pajisura me certifikatë veterinare;
- f) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

14.2. Kriteret konkurruese

- | | |
|---|---------|
| • Numri i krerëve dele/dhi të matrikulluara | 75 pikë |
| • Raca | 10 pikë |
| • Statusi aplikantit | 15 pike |

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

14.3. Procedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare për këtë skemë mbështetëse bëhet : 15 Mars deri në 30 Prill 2013

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë zyrës së Bujqësisë në rreth sipas formularit të aplikimit (Formulari 14/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Regjistri elektronik i deleve/dhive të matrikulluara me seritë përkatëse;
- Certifikata veterinare e tufës së deleve/dhive;
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 14/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 14/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje të formularit 14/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brënda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brënda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brënda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 14/4).

DRBU grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b. Vlerësimi

Vlerësimi i aplikimeve bëhet sipas kritereve të konkurueshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR Qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 14/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual.
- b. Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- c. Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPÇSSHB).

Vlerësimi maksimal për numrin e krerëve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të deleve/dhive të matrikulluara, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me numrin më të madh të të imtave pleje.

Përsa i përket racës pikët maksimale (10), i marrin feramat me dele/dhi të racave të pastra dhe 5 racave të kryqëzuara,

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve të kësaj skeme për çdo rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 14/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 14/7).

Të dy formularët (14/6 dhe 14/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk meren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

c. Regjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuar. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

d. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e aplikimeve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve" i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohen nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi e verifikimit bën verifikimin në vend të numrit të deleve/dhive të matrikulluara sipas regjistrin të fermës dhe faktit, kontrollojnë dokumentacionin e fermës dhe plotëson formularin e kontrollit (Formulari 14/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse aplikimi është në përputhje me udhëzimin dhe aplikimin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

Grupi i verifikimit brënda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit

(Formulari 14/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 14/9 dhe 14/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

15. Në vlerën 5,000 (pesë mijë) lekë/krerë dele ose dhi race e pastër për fermat që mbarështojnë mbi 10 (dhjetë) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë.

15.1. Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues nga kjo masë mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerët individualë dhe subjektet me status fizik ose juridik;
 - Anëtarët e një organizate racore të miratuar;
- b) Fermat blegtorale që mbarështojnë dele të racave të pastra (Awassi dhe Chios), dhi të racave të pastra (Alpine dhe Sana) ose janë furnizuar nga importi me kafshë të këtyre racave (nga vendet e BE) me jo më pak se 10 krerë (dele ose dhi) pleje të matrikulluara. Paga bëhet deri në 50 krerë;
- c) Fermat që kanë për çdo dele ose dhi pleje Dokumentin Zooteknik të racës përkatëse (të lëshuar nga Zootekniku i DRB për rastin e deleve ose dhive të riprodhuara në vend); për rastin e deleve ose dhive të importuara Dokumentin Zooteknik të racës së vendit përkatës të BE;
- d) Paga i bëhet subjektit që zotëron kafshet e matrikulluar dhe certifikuar në kontrollin përfundimtar.
- e) Tufa e të imtave në fermë të jetë e pajisur me certifikatë veterinare;
- f) Të ketë bërë shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

15.2. Kriteret konkurruese

- | | |
|--|---------|
| a) Numri i krerëve të deleve, dhive pleje të matrikulluara | 65 pikë |
| b) Fermat, për kafshët e të cilave disponohen të dhëna për prejardhjen për më shumë se një brezni. | 15 pikë |
| c) Statusi i aplikantit | 15 pikë |
| d) Fermer nën moshën 40 vjeç | 5 pikë |

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

15.3. Procedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare për këtë skemë mbështetëse fillon më 1 mars dhe përfundon më 31 Mars të vitit 2013.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë në rreth sipas formularit të aplikimit (Formulari 15/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Regjistri elektronik i deleve/dhive të matrikulluara me seritë përkatëse;
- Certifikata veterinare e tufës së deleve/dhive;
- Dokumentacioni zooteknik
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 15/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 15/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje të formularit 15/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditë pune tek drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brënda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 15/4).

DRBU grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b. Vlerësimi

Vlerësimi i aplikimeve bëhet sipas kriterëve të konkurueshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brënda 10 ditëve pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 15/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual.
- b. Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- c. Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPÇSSHB).

Vlerësimi maksimal për numrin e krerëve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të deleve/dhive të matrikulluara, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me numrin më të madh të të imtave plleja.

Përsa i përket të dhënave të prejardhjes pikët maksimale (10), i marrin fermtat me dele/dhi të racave të pastra me të dhëna për më shumë se një brezni.

Vlerësim maksimal për moshën 5 pikë e mer fermeri me moshë nën 40 vjeç në momentin e aplikimit.

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve të kësaj skeme për çdo rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së

projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 15/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 15/7).

Të dy formularët (15/6 dhe 15/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR Rajonale dosjet e kompletuara.

c. Regjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

d. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Verifikimi i fermës blegtorale të deleve dhive race paster bëhet në periudhën 10 Prill - 30 Maj 2013 .

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi e verifikimit bën verifikimin në vend të numrit të deleve/dhive race paster të matrikulluara sipas regjistrat të fermës dhe faktit, kontrollojnë dokumentacionin e fermës dhe plotëson formularin e kontrollit (Formulari 15/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse aplikimi është në përputhje me udhëzimin dhe aplikimin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

Grupi i verifikimit brënda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 15/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 15/9 dhe 15/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

16. Në vlerën 5,000 (pesë mijë) lekë/krerë për vicat për majmëri për fermat që mbarështojnë mbi 10 (dhjetë) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë.

16.1 Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Fermat blegtorale që rrisin ose janë furnizuar nga importi me jo më pak se 10 krerë, të matrikulluar e kodin nacional dhe të regjistruar në regjistrin e fermës;
- c) Fermat që i kanë viçat present në fermë për periudhën nga data e aplikimit deri në momentin e verifikimit për pagesë;
- d) Pagesa i bëhet subjektit seri në 50 krerë dhe që zotëron viçat e matrikulluar dhe regjistruar në kontrollin përfundimtar;
- e) Tufa e gjedhit në fermë të jetë e pajisur me certifikatë veterinare;
- f) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

16.2. Kriteret konkurruese

a) Numri i krerëve të vicave për majmëri të matrikulluara	45 pikë
b) Fermat, që rrisin vica të racave të mishit, të kombinuara dhe kryqezimeve me keto raca.	35 pike
c) Statusi i aplikantit	15 pikë
d) Fermer nën moshën 40 vjeç	5 pike
TOTALI	100

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

16.3. Procedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare për këtë skemë mbështetëse fillon më 15 shkurt dhe përfundon më 30 Mars të vitit 2013.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë në rreth sipas formularit të aplikimit (Formulari 16/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Regjistri elektronik i vicave të matrikulluara me seritë përkatëse të kodit nacional;
- Certifikata veterinare e tufës së vicave;
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 16/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 16/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje të formularit 16/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve tek Drejtori i DRB-së, i cili i duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB - qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 16/4).

DRBU grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b. Vlerësimi

Vlerësimi i aplikimeve bëhet sipas kritereve të konkurueshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet "Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve", i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR Qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 16/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual.

- b. Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- c. Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPÇSSHB).

Vlerësimi maksimal për numrin e kërësve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të viçave të matrikulluara, të tjerët vlerësohen në përpjestim të drejtë me numrin më të madh të viçave.

Përsa i përket racës pikët maksimale (10), i marrin fermtat me vica të racave me drejtim mishi ose kryqëzimet e tyre dhe me 5 pikë vlerësohen fermtat me vica të racave të kombinuara ose kryqëzimet e tyre.

Vlerësim maksimal për moshën 5 pikë e mer fermeri me moshë nën 40 vjeç në momentin e aplikimit.

Brënda 5 ditëve pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve të kësaj skeme për çdo rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vënde publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 16/6), dhe rregjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 16/7).

Të dy formularët (16/6 dhe 16/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR

c. Regjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

d. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Verifikimi i fermës blegtorale të vicave për majmëri bëhet në periudhën 01 Shtator - 15 tetor 2013

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi e verifikimit bën verifikimin në vend të numrit vicave për majmëri të matrikulluara sipas regjistrat të fermës dhe faktit, kontrollon dokumentacionin e fermës dhe plotëson formularin e kontrollit (Formulari 16/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse aplikimi është në përputhje me udhëzimin dhe aplikimin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

Grupi i verifikimit brënda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 16/8) në AZHBR Qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtorinë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 16/9 dhe 16/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme të AZHBR.

17. Në vlerën 600 (gjashtëqind) lekë/koshere blete për fermerët me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere bletë.

17.1. Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Aplikantët me jo më pak se 50 koshere blete;
- c) Të ketë aktivitet të identifikueshëm nga DRB-ja;
- d) Bletët të jenë të certifikuara me status shëndetësor "e pastër nga Nozematoza ose Pesta";
- e) Përfituesi të ketë bërë shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

17.2. Kriteret konkurruese

Numri i koshereve	85 pikë
Statusi i aplikantit	15 pikë
TOTALI	100 pike

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

17.3 Procedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 1 Maj - 30 Qershor 2012.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë në rreth sipas formularit të aplikimit (Form. 17/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vërtetimin nga DRB ku vërtetohet aktiviteti dhe numri i koshereve që disponon;
- Certifikata veterinare e bletëve;
- Dokument që vërteton statusin e aplikantit (emigrant, subjekt, organizatë);
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit;
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 17/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 17/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje të formularit 17/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brënda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brënda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brënda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (Formulari 17/4).

DRB-ja grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kriterëve të konkureshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 17/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual.
- b. Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- c. Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPÇSSHB).

Vlerësimi maksimal për numrin e koshereve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të koshereve të aplikuara, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me numrin më të madh të koshereve të aplikuara.

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve të kësaj skeme për çdo rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 17/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 17/7).

Të dy formularët (17/6 dhe 17/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRBUMK në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

c. Regjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

d. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Verifikimi i koshereve të bletëve bëhet në periudhën Shtator - Tetor 2012.

Me fillimin e procedurës së verifikimit, aplikanti është i detyruar të grumbullojë kosheret në një vend brënda qarkut në të cilën ka aplikuar, dhe të njoftojë përfaqësuesin e AZHBR për momentin dhe vëndin e verifikimit.

Brënda 15 ditëve nga marrja e njoftimit grupi e verifikimit bën verifikimin në vënd të aplikimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi bën verifikimet dhe numerimet e nevojshme, markon kosheret e numeruara dhe plotëson formularin e verifikimit të aplikimit (Formulari 17/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse aplikimi është në përputhje me udhëzimin dhe aplikimin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 17/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtorinë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 17/9 dhe 17/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme të AZHBR.

18. Në vlerën 20,000 (njëzet) mijë lekë për kokë mëshqere, racë e pastër, të moshës mbi 15 (pesëmbëdhjetë) muaj në zona të caktuara ku ekziston përqëndrimi më i madh i gjedhit, për fermat ose grup fermash blegtorale që prodhojnë jo më pak se 3 (tri) mëshqera por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë.

18.1 Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues nga kjo masë mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerët individualë dhe subjektet me status fizik ose juridik
 - Anëtarët e një organizate racore të miratuar
- b) Fermat blegtorale që prodhojnë ose janë furnizuar nga importi (nga vendet e BE) me jo më pak se 3 por jo më shumë se 50 mëshqerra të matrikulluara racë-pastër (Xhersi dhe Holshtejn/Laramane), ku evidentohet se brenda vitit buxhetor janë jo më pak se 15 muajshe.
- c) Fermat që kanë për çdo mëshqerrë dokumentin zooteknik të racës përkatëse (të lëshuar nga zootekniku i DRB për rasin e mëshqerrave të vendit); për rastin e mëshqerrave të importuara (Dokumentin zooteknik të racës së vendit përkatës të BE)
- d) Paga i bëhet subjektit që e zotëron mëshqerrën e matrikulluar dhe certifikuar në kontrollin përfundimtar.
- e) Përfitojnë fermat që gjenden në qarqet Fier, Shkodër, Elbasan, Tiranë, Durrës, Korçë dhe Lezhë.
- f) Tufa e gjedhit në fermë të jetë e pajisur me certifikatë veterinare
- g) Të ketë bërë shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

18.2 Kriteret konkurruese

a) Numri i krerëve të mëshqerrave të matrikulluara që brenda vitit buxhetor verifikohet se mbushin moshën 15 muajshe	40 pikë
b) Projekti i stallës	30 pikë
c) Fermat, për kafshët e të cilave disponohen të dhëna për prejardhjen për më shumë se një brezni.	15 pikë
d) Statusi i aplikantit	15 pikë
TOTALI	100 pike

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

18.3. Procedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 1 Maj 2013 dhe përfundon më 30 Qershor të 2013.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR sipas formularit të aplikimit (Formulari 18/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Projekti i stallës (Sipas Formularit 18/2);
- Regjistri i fermës së gjedhit;
- Çertifikata veterinare e tufës
- Dokument që vërteton statusin e aplikantit
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 18/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 18/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje të formularit 18/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 18/4).

DRBU grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kriterëve të konkurueshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR Qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditëve pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 18/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a. 5 pikë aplikanti individual.
- b. Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- c. Anëtarë të organizatave racore 15 pikë.
- d. Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPÇSSHb).

Vlerësimi maksimal për numrin e krerëve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të mëshqerrave, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me numrin më të madh të mëshqerrave të aplikuara.

Vlerësimin maksimal për pikën c (15 pikë), e marrin aplikantët, të cilët disponojnë të dhëna për prejardhjen e mëshqerrave për më shumë se një brezni. Me 10 pikë vlerësohen aplikantët, të cilët disponojnë të dhëna të pjesshme për prejardhjen e mëshqerrave.

Vlerësimi për pikën b) bëhet sipas pikëve që kanë elementët e stallës në aneksin përkatës të këtij udhëzimi, për projektet e stallës ku mbarështohen këto kafshë.

Brënda 5 ditëve pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve të kësaj skeme për çdo rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 18/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 18/7).

Të dy formularët (18/6 dhe 18/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRBUMK në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

e. Regjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuar. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

5. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Verifikimi i skemës së mëshqerave bëhet në periudhën 1 Gusht – 30 Tetor 2012.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i Verifikimit të Projekteve”, i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij bën verifikimin në vend të mëshqerave sipas regjistrit të fermës dhe faktit, bën matjet dhe verifikimet e nevojshme të stallës dhe plotëson formularin e verifikimit (Formulari 18/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitimit si dhe me parametrat e stallës, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse gjendja faktike e fermës është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar. Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Dokumentacionin Zooteknik për prejardhjen e çdo mëshqerre që kërkon të subvencionohet.
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 18/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 18/9 dhe 18/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse.

Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

19. Mbështetja, përmes subvencionit, në masën 70% të normës së interesit, për 5 (pesë) vite radhazi, për kreditë deri në 25,000,000 (njëzet e pesë milion) lekë, që do të merren për aktivitetet e mëposhtme:

- a. Ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, kërpudhës dhe bimëve medicinale;
- b. Mjetet mekanike bujqësore, agregate dhe tank ftohës për qumështin;
- c. Peshkimin dhe përpunimin e produkteve ujore;
- ç Veprimtarite në agro dhe ekoturizem

19/a-c-ç. Ruajtja dhe përpunimi i produkteve bujqësore, blegtorale, kërpudhës, bimëve medicinale, peshkimi dhe përpunimi i produkteve ujore. Veprimtarite në agro dhe ekoturizem

Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Përfitojnë projektet për blerje anijesh të reja peshkimi dhe rinovim të flotës ekzistuese;
- c) Përfitojnë projektet për blerjen e linjave të reja për përpunim të produkteve bujqësore, blegtorale, kërpudhës;
- d) Përfitojnë projektet që kërkojnë të zëvendësojnë pjesërisht teknologjitë dhe linjat ekzistuese me blerjen e makinerive të reja për përpunimin e produkteve të pësipërme;
- e) Përfitojnë projektet për blerjen e dhomave të ruajtjes frigoriferike;
- f) Përfitojnë projektet për ndërtimin e magazinave për grumbullim, përpunim apo ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale;
- g) Përfitojnë projektet për veprimtarite në agro dhe ekoturizem
- h) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Kriteret Konkurruese

a. Koha prej të cilës ushtron aktivitetin subjekti	10 pikë
b. Biznes plan i detajuar për ecurinë financiare për 5 vitet në vazhdim të subjektit që financohet	40 pikë
c. Pjesëmarrje me kapitalet e veta në investimin.	25 pikë
d. Subjekte që investojnë për mbylljen e ciklit të një produkti (Filiera)	10 pikë
e. Statusi i aplikantit	15 pikë
TOTALI	100 pike

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a) 5 pikë aplikanti individual.
- b) Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- c) Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- d) Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Vlerësimi maksimal për kohën e aktivitetit e marrin subjektet të cilat kanë qenë aktivë në 2 vitet e fundit.

Do të ketë vlerësimin maksimal biznes plani i strukturuar në paraqitjen e të dhënave financiare të subjektit, planin e investimit dhe parashikimi në lidhje me sektorin dhe tregun.

Vlerësohen maksimalisht subjektet që mbulojnë me kapitalet e tyre përqindjen më të lartë të investimit.

Vlerësohen maksimalisht, subjektet që investojnë për mbylljen e ciklit të produktit (filiera).

Për aplikantët të vlerësuar me pikë të barabarta gjatë procesit të vlerësimit, renditja e tyre bëhet sipas parimit “Renditet i pari, kush aplikon i pari”

Procedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Aplikimi për subjekte fizik/juridik

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten nga data 01 Mars deri më 30 Maj 2013.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten në AZHBR Qendër, sipas formularit të aplikimit (**Formulari 19/1**).

AZHBR plotëson Formularin e pranimit (**Formulari nr.19/2**). Një kopje e këtij formulari i jepet aplikuesit.

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim subjekti aplikues duhet të dorëzojë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Dokumenti ligjor i shoqërisë/Personit Fizik
- b. Dokument nga zyra e tatimeve që vërteton se subjekti nuk ka detyrime tatimore
- c. “Leter of intend/comfort” për financimin e projektit të lëshuar nga banka.
- d. Dokumenti nga rregjistri i kredisë që konfirmon që aplikanti nuk ka detyrime ose borxh të keq me institucione të tjera financiare (ky dokument merret në bankën që ka lëshuar dokumentin e pikës 1)
- e. Bisnesplanin e detajuar. (minimum 5 vjeçar)
- f. Ofertën për makineritë, linjën e marrë në konsideratë nga banka gjatë shqyrtimit të kërkesës për kredi.
- g. Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- h. Dokumentin e pronësisë për kolateralin e lënë garanci për kredinë e marrë. (kontratë hipoteke për pasuritë e paluajtëshme, kontratë e pengut për makineri dhe paisje të lëna garanci ose dokumentin e pronësisë mbi pasuri të paluajtëshme apo pengje që do të përdoren për kolateral)
- i. Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.
- j. Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje të jete i noterizuar.

AZHBR regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në regjistrin e aplikimit të AZHBR (**Formulari 19/4**)

b. Vlerësimi

AZHBR qendër me mbarimin e afatit të aplikimit dhe marrjen e kërkesave, brënda muajit Qershor 2013, bën vlerësimin e kërkesave të paraqitura dhe përzgjedhjen e subjekteve/fermerëve fitues.

“Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve” përbehet nga 5 (pesë) përfaqësues të AZHBR.

Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve bën vlerësimet e kërkesave të paraqitura me pikë sipas kritereve të konkurrenshmërisë (**Formulari i Vlerësimit 19/5**).

Niveli maksimal i vlerësimit do të jetë 100 pikë. Fitues mund të jetë çdo projekt me të paktën 60 pikë.

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, komisioni i vlerësimit bën renditjen e projekteve sipas rendit zbritës të pikëve, nga projektet me pikë maksimale deri të projektet me pikë minimale dhe me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR bën shpalljen e listave të projekteve fituese dhe jo fituese në vende publike. (Formulari 19/7)

Pas mbarimit të procesit të vlerësimit, AZHBR duhet të lidhë kontratë/marrëveshje me bankën/shoqërinë kredituese për çdo aplikant fitues.

Për të subvencionuar normën e interesit, subjekti/fermeri fitues paraqet pranë AZHBR kontratën e kredisë me bankën, me objektin e përcaktuar sipas biznes planit për të cilën është disbursuar kredia gjatë vitin 2013 dhe planin e shlyerjes së kredisë.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion AZHBR njofton subjektet/fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

c. Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e realizimit të punës dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, "Grupi i Kontrollit" i përbërë nga 3 pjesëtarë nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR dhe sipas rastit ekspertë të fushave përkatëse të sektorëve që mbështeten, verifikojnë në terren realizimin e projektit konform planit të biznesit dhe ofertës përkatëse.

Në përfundim të verifikimit në terren, plotësohet **Formulari nr. 19/8**.

AZHBR pas verifikimit të procedurave të ndjekura nëpër të cilat kalon aplikimi, është e detyruar të bëjë xhirimin e parave (shumën e normës së interesit të subvencionuar) në numrin e llogarisë së bankës/shoqërisë kredituese me të cilën përfituesi ka kontratë.

19/b. Mjete mekanike bujqësore, agregate dhe tank ftohës për qumështin

Kriteret e përfitimit

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Përfitojnë fermerët që kanë mbi 2 ha tokë bujqësore arë/pemëtoje/ullishte/vresht, ose mbi 5 dynym serrë diellore ose me ngrohje teknike ose fermerë me jo më pak se 10 krerë lope qumështi ose fermerë/individë që kryejnë shërbime për të tretë;
- c) Përfitojnë ata fermerë që:
 - Së bashku me traktorin/traktoret blejnë edhe një agregat/agregate bujqësor (makinë mbjellëse/plug/frezë/disk/pompë spërkatëse), rimorkio, bote urine;
 - Blejnë agregat/agregate bujqësore (makinë mbjellëse/plug/frezë/disk/pompë spërkatëse), rimorkio, bote urine;
 - Blejnë tank ftohës për qumështin;
- d) Toka të jetë në pronësi ose në përdorim të aplikantit të paktën mbi 5 vjet (në rastet e mjeteve mekanike dhe agregateve);
- e) Aplikanti të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- f) Të ketë bërë "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

Kriteret konkurruese për mekanikën bujqësore

- a. Zona me potencial të lartë bujqësor: **10- pike**

- b. Siperfaqja e fermës/Numri krerëve: **25-pike** – Vlerësimi maksimal aplikantët që kanë sipërfaqen dhe numrin më të madh të fermës.
- c. Llojet e aktiviteteve që kryen fermeri : **20- pike** Pikët maksimale ai që ushtron aktivitetin në bujqësi blegtori apo shërbime ndaj të tjerëve.
- d. Investimi i pjesshem ose i plotë: **15- pikë**, Vlerësohen maksimalisht fermerët/individët që investojnë në blerjen e mjeteve dhe agregatit së bashku.
- e. Pjesëmarrje me kapitalin e vetë në investimin: **15- pike**, Vlerësohen maksimalisht fermerët që mbulojnë me kapitalin e tyre përqindjen më të lartë të investimit
- f. Statusi i aplikantit (emigrant i kthyer, Shoqëri Bashkëpunimi Bujqësor, subjekt me status fizik juridik): **15 pike**

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- 5 pikë aplikanti individual.
- Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- Për aplikantët me status “**Emigrant i kthyer**” 5 pikë shtesë.

Procedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Aplikimi për subjekte fizik/juridik, fermeret individuale/grup fermeresh

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten nga data 01 Mars deri më 30 Maj 2013.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten në AZHBR Qendër, sipas formularit të kërkesës për aplikim (**Formulari nr 19/1**).

AZHBR plotëson Akt Pranimin (**Formulari nr.19/3**). Një kopje e këtij formulari duhet t’i jepet aplikuesit.

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim subjekti/fermeri duhet të dorëzojë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Dokumenti ligjor i shoqërisë/Personit fizik. Në rastin kur aplikanti është një fermer individual fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës.
- b. Dokument nga zyra e tatimeve që vërteton se subjekti nuk ka detyrime tatimore. (Me përjashtim të fermerëve individualë)
- c. “Leter of intend/comfort” për financimin e mjetit të lëshuar nga banka.
- d. Dokumenti nga rregjistrimi i kredisë që konfirmon faktin që aplikanti nuk ka detyrime ose borxh të keq në institucione të tjera financiare (ky dokument merret në bankën që ka lëshuar dokumentin e pikës 1)

- e. Dokumenti i pronësisë së tokës/rrgjistri i fermes se lopëve¹
- f. Vërtetim nga Komuna/Bashkia dhe mandat arkëtimi përkatës, që vërtetojnë pagesën e taksës së tokës për vitin 2013.
- g. Ofertën për traktorin/traktorët, agregat/agregatet bujqësor (makinë mbjellëse/ plug/ freze / disk / pompe spërkatëse), rimorkio, bote urine e marrë në konsideratë nga banka gjatë shqyrtimit të kërkesës për kredi.
- h. Dokumentin e pronësisë për kolateralin e lënë garanci për kredinë e marrë. (kontratë hipotekë për pasuritë e paluajtshme, kontratë e pengut për makineri dhe paisje të lëna garanci ose dokumentin e pronësisë mbi pasuri të paluajtshme apo pengje që do të përdoren për kolateral).
- i. Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.
- j. Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorezohet si fotokopje te jete i noterizuar.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentat e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP)
- Akti i pronësisë së tokës (Sipas ligjit 7501).
- Vërtetim pronësie nga Komuna/Bashkia në rastet kur nuk ka përfunduar shpërndarja e titujve të pronësisë, të lëshuar nga specialisti i zyrës përkatëse të komunës/Bashkisë sipas formularit bashkëngjitur udhëzimit.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me komunat (Kontratë tip)
- Kontratë qiraje me individë

Kontrata e qirasë në të dyja rastet për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të jetë e noterizuar. Në rastet kur nuk ka përfunduar azhurnimi i tokës bujqësore të përdoret kontrata tip.

AZHBR regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Aplikimit të AZHBR (Formulari nr. 19/4)

b. Vlerësimi

AZHBR qendër me mbarimin e afatit të aplikimit dhe marrjen e kërkesave, brënda muajt Qershor 2013, bën vlerësimin e kërkesave të paraqitura dhe përzgjedhjen e fermerëve/individëve fitues.

“Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve” përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues të AZHBR.

Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve bën vlerësimet e kërkesave të paraqitura me pikë sipas kritereve të konkurrenshëmërisë (**Formulari i Vlerësimit 19/6**).

¹ Dokumenti i pronësisë se tokes kerkohet kur kredia eshte kerkuar per blerjen e mjeteve mekanike bujqesore dhe agregateve ndihmese. Ne rastet e aplikimit per tank ftohes per qumeshtin aplikanti paraqet regjistrin e fermes se lopeve.

Niveli maksimal i vlerësimit do të jetë 100 pikë. Konsiderohen fitues ato aplikime që janë vlerësuar 60-100 pikë.

Brënda 5 ditëve pune pas vlerësimit, komisioni i vlerësimit bën renditjen e projekteve sipas rendit zbritës të pikëve, nga projektet me pikë maksimale deri te projektet me pikë minimale dhe me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR bën shpalljen e listave të projekteve fituese dhe jo fituese në vende publike. **(Formulari 19/7)**

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion AZHBR njofton fermerët/individët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Pas mbarimit të procesit të vlerësimit, AZHBR duhet të lidhë kontratë/marrëveshje me bankën/shoqërinë kredituese për çdo aplikant fitues.

Për të subvencionuar normën e interesit, subjekti/fermeri fitues paraqet pranë AZHBR kontraten e kredisë me bankën, me objektin e përcaktuar sipas biznes planit për të cilën është disbursuar kredia gjatë vitin 2013 dhe planin e shlyerjes së kredisë.

c. Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e realizimit të punës dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, “Grupi i Verifikimit” i përbërë nga 3 pjesëtarë nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR dhe sipas rastit ekspertë të fushave përkatëse, verifikojnë në vënd blerjen e mjeteve mekanikë bujqësore dhe agregateve përkatës konform ofertës së paraqitur.

Në përfundim të Verifikimit në terren, plotësohet **Formulari nr. 19/9**.

AZHBR pas verifikimit të procedurave të ndjekura nëpër të cilat kalon aplikimi, është e detyruar të bëjë xhirimin e parave (shumën e normës së interesit të subvencionuar) në numrin e llogarisë së bankës/shoqërisë kredituese me të cilën përfituesi ka kontratë.

20. Për grumbullimin e gështenjës, boronicës dhe shegës, në vlerën 1,200 (një mijë e dyqind) lekë/kv. Pagesa të bëhet vetëm kundrejt sasive të gështenjave, boronicave dhe të shegëve të shitura me faturë tatimore.

20.1. Kriteret e përfitimit

- a. Përfitojnë të gjithë personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë aktivitet tregëtar dhe që janë të regjistruara në organet tatimore.
- b. Përfitojnë ata grumbullues që sigurojnë ruajtjen e prodhimit dhe kryejnë shërbimet e pasvjeles;
- c. Pagesa të bëhet vetëm kundrejt sasive të gështenjave, boronicës dhe shegëve të shitura me faturë tatimore
- d. Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

20.2. Proçedura që do të ndiqet

a. Aplikimi

Aplikimi për mbështetje financiare për këtë skemë bëhet në 1 Korrik - 20 Gusht 2013

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë në Rreth sipas formularit të aplikimit (Formulari 20/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Dokumentin e regjistrimit në tatim – taksa;
- b) Dokument nga zyra e tatimeve që vërteton se subjekti nuk ka detyrime tatimore;
- c) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit;
- d) Vërtetim banke për numrin e llogarisë;
- e) Planvendosje e mjediseve të grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimit;
- f) Dokumentin që vërteton pronësinë ose të drejtën e përdorimit të mjediseve të ruajtjes.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet në Zyrën e Bujqësisë së Rrethit e cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimeve së bashku me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimi (Formulari 20/3).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje të formularit 20/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili i duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së Rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e aplikimit për rrethin (Formulari 20/4).

DRB grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

Me marrjen e të gjithë listave dhe dokumentacionit DRB-të bëjnë transferimin e dokumentacionit të aplikantëve nga DRB -të në AZHBR rajonale sipas formularit 20/7.

Dorëzimi bëhet në mënyre protokollare sipas renditjes së projekteve në regjistrin e aplikantëve të rrethit. Për çdo dosje të dorëzuar plotësohet formulari i dorëzimit të dosjes (Formulari 20/6).

Të dy formularët (20/6 dhe 20/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në rolin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në rolin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR - së. DRB-të brenda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

b. Regjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR Qendër.

d. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e dorëzimi dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i Verifikimit të Projekteve”, i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi bën verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (Formulari 20/8). Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse aplikimi i fermerit është në përputhje me udhëzimin dhe kriteret e përfitimit.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturën/Faturat tatimore të shitjes së gështenjës/shegës/boronicës;
- Listën e fermerëve nga të cilët grumbullon gështenjën/shegën/boronicën me sasitë përkatëse të firmosur nga vetë fermerët.
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 20/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 20/9 dhe 20/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse.

Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

21. Për mbarështimin intensiv të kërmillit, në masën 50% të vlerës së rasatit për ha, por jo më shumë se 500,000 (pesëqind mijë) lekë/ha. Kjo mbështetje të jetë për ata që fillojnë investimin për mbarështimin e kërmillit për herë të parë.

Për mbarështuesit që e kanë bërë investimin fillestar më parë të vihet mbështetje e fermave që bëjnë mbarështimin intensiv të kërmillit me një vlerë 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

21.1 Kriteret e përfitimit

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;

b) Fletë analize për sasinë e Ca në tokën ku do të kultivohet kërmilli;

c) Të ketë certifikatë veterinare;

d) Të ketë bërë shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

21.2 Kriteret konkurruese

• Madhësia e fermës	55 pikë
• Teknologjia e kultivimit	20 pikë
• Plan biznesi	10 pikë
• Statusi i aplikantit	15 pikë
TOTALI	100 pike

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

21.3 Proçedura që do të ndiqet për skemën e kërmillit

a) Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon me 15 Shkurt 2013 dhe përfundon me 30 Mars 2013.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë në Rreth sipas formularit të aplikimit (Form. 21/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Projektin e plotë i cili duhet të përmbajë këto elementë:
 - Teknologjia e Kultivimit
 - Kostoja e projektit të kultivimit me zëra dhe elementë
 - Sasia e prodhimit

- Të ardhurat nga shitja
- Strategjia e shitjeve
- Dokument që vërteton statusin e aplikantit
- Certifikata veterinare.
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 21/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 21/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje të formularit 21/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve tek Drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 21/4).

DRBU grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b) Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kriterëve të konkurueshmërisë së skemës përkatëse dhe është në përgjegjësi të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet "Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve", i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR Qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 21/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- 5 pikë aplikanti individual.
- Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- Për aplikantët me status "**Emigrant i kthyer**" 5 pikë shtesë.

Brënda 5 ditëve pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë dhe rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 21/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 21/7).

Të dy formularët (21/6 dhe 21/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR Rajonale dosjet e kompletuara.

a. Regjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR Qendër.

b. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në regjistrin e aplikimeve të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR rajonale organizon verifikimin në terren të aplikimeve që kanë fituar të drejtën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij bën verifikimin e investimit, matjet përkatëse dhe plotëson në vend formularin e verifikimit. (Formulari 21/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë dhe parametrat e projektit në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturën tatimore të blerjes së rasatit në rastin e aplikimit për ngritje investimi e shoqëruar me kasën fiskale të subjektit tregëtues
- Kontratën e shitjes së prodhimit ose faturat e shitjes (kur kemi aktivitet 2-3 vjeçar).
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton më i vogël se 10% aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar.
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10% aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plote të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 21/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (Formularët 21/9 dhe 21/9/a).

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse.

Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga drejtoria e Kontrollit të AZHBR Qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

22. Për mbjellje të bimëve medicinale të kultivuara si sherebelë, lavanda, timus, rigon dhe rozmarinë, në bllok e sipas zonave të përcaktuara më parë për kultivim, në masën 50% të kostos totale të projektit, por jo më shumë se 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha.

22.1 Kritere e përfitimit

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor;
- b) Përfitojnë vetëm aplikantët për mbjellje të reja;
- c) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 5 dynym dhe jo më e madhe se 5 ha;

- d) Toka të jetë në pronësi, në përdorim ose me qira të paktën për një periudhë 10 vjeçare;
- e) Mbjellja mund të bëhet në zërin kadastral tokë bujqësore/kullotë/pyll/livadh. Në çdo rast të sipërcituar sipërfaqja e mbjellje duhet të jetë e shpyllëzuar nga shkurret dhe drurët pyjorë.
- f) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin Nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- g) Të ketë kontrata me firmat grumbulluese;
- h) Speciet që parashikohen në projekt duhet të jenë brenda listës së përcaktuar në Aneksin 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- i) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2013;
- j) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

22.2 Kriteria konkurruese

a) Sipërfaqja që do të mbillet	45 pikë;
b) Specia sipas rajonizimit	15 pikë;
c) Teknologjia e kultivimit	30 pikë;
d) Statusi i aplikantit	15 pikë.
TOTALI	100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

22.3. Procedurat që do të ndiqen për skemën e mbjelljes së bimëve medicinale

a) Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare për mbjelljen e bimëve medicinale të kultivuara fillon me 10 Shkurt deri në 31 Mars 2013. (si për mbjelljet e pranverës, ashtu edhe për ato të vjeshtës- Shtator-Tetor).

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë Zyrës së Bujqësisë në Rreth sipas formularit të aplikimit (Formulari 22/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Projekti (Sipas Formularit. 22/2);
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit;
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë;
- Dokument që vërteton statusin e aplikantit (emigrant, subjekt, SHBB);
- Dokumenti i pronësisë së tokës.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentat e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP);

- Akti i pronësisë së tokës (Sipas ligjit 7501);
- Vërtetim pronësie nga Komuna/Bashkia në rastet kur nuk ka përfunduar shpërndarja e titujve të pronësisë, të lëshuar nga specialisti i zyrës përkatëse të komunës/Bashkisë sipas formularit bashkëngjitur udhëzimit;

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me komunat (Kontratë tip);
- Kontratë qiraje me individë.

Kontrata e qirasë në të dyja rastet për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të jetë e noterizuar. Në rastet kur nuk ka përfunduar azhurnimi i tokës bujqësore të përdoret kontrata tip.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i Zyrës së Bujqësisë së rrethit i cila bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, plotëson formularin e pranimi (Formulari 22/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 22/4).

Në këtë moment aplikantit i vendoset kodi i aplikimit i cili shënohet nga përfaqësuesi i ZBRR në formularin e pranimi. Një kopje e formularit 22/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve tek drejtori i DRB-së, i cili duhet ti japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit Zyra e Bujqësisë së rrethit i dorëzon aplikimet (dosjet komplet), në DRB qark, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimi për rrethin (Formulari 22/4).

DRB grumbullon listat e ZBRR dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në Zyrën e Bujqësisë në rreth për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve.

b) Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kritereve të konkurueshmërisë së skemës përkatëse dhe është në kompetencë të DRB-së.

Në çdo DRB ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 veta dhe konkretisht :

1. Drejtori i DRB-së - kryetar,
2. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
3. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DRB - anëtar
4. Një përfaqësues i AZHBR qendër - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DRB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (Formulari 22/5).

Për statusin e aplikantit : Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- 5 pikë aplikanti individual.

- Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë
- Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor 15 pikë.
- Për aplikantët me status **“Emigrant i kthyer”** 5 pikë shtesë.

Që të përfitojë këtë vlerësim aplikanti duhet të paraqesë fotokopjen e dokumentit të “Statusit të Emigrantit”, lëshuar nga Zyra Përkatëse e Punësimit pranë njësive të qeverisjes vendore (Urdhëri Nr. 1712, datë 18.09.2007, i ndryshuar MPÇSSHB).

Vlerësimi maksimal për specien e marrin projektet që parashikojnë mbjelljen e specieve sipas rajonizimit të dhënë në Aneksin 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Vlerësimi maksimal për sipërfaqen e fiton aplikuesi me sipërfaqe më të madhe të aplikuar, të tjerët vlerësohen në përpjestim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

Vlerësimin maksimal për teknologjinë e marrin ato aplikime që parashikojnë ndërhyrje më të mëdha në mobilimin e tokës, masat antierozive, kulluese etj, të parashikuara në preventivin e punimeve.

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, DRB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë dhe rreth sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet Zyrave të Bujqësisë në rreth bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vënde publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DRB-së në çdo faqe ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DRB-të dërgohen në AZHBR qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën indo@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DRB-të në AZHBR-në rajonale. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 22/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR rajonale (Formulari 22/7).

Të dy formularët (22/6 dhe 22/7), firmosen nga përfaqësuesi i DRB në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-së. DRB-të brënda 10 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë në AZHBR rajonale dosjet e kompletuara.

c) Rregjistrimi i aplikimeve në Data Base

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në Data Base të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

d) Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i Verifikimit të Projekteve", i përbërë nga 2 specialistë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është mbjellja e bimëve medicinale sipas projektit të vlerësuar.

Menjëherë pas përfundimit të punës dhe mbjelljen e parcelës fermeri njofton AZHBR në rajon. Kjo e fundit dërgon Grupin e Verifikimit të Projekteve për verifikimin në vënd të realizimit të projektit duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (Formulari 22/8). Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë dhe parametrat e projektit në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturën tatimore të blerjes së materialit mbjellës;
- Një kopje të certifikatës së garancisë së materialit mbjellës (fidanit), ku të jetë shënuar specia, me vulën origjinale (të njomë).
- Vërtetim nga Komuna/Bashkia dhe mandat arkëtimi përkatës, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2013.
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

Grupi i verifikimit brënda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 22/8) në AZHBR qendër, përkatësisht në DSAP në rastin e konfirmimit të projektit ose në SARK në rastin e refuzimit të tij.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në rrugë protokollare në drejtoritë përkatëse të AZHBR duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve në AZHBR (Formularët 22/9 dhe 22/9/a).

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton më i vogël se 10% aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar.

- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10% aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike.

AZHBR qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumentave të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në SARK me argumentin përkatës.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendëshme të AZHBR.

23. Për mbështetjen e SHBB-ve për projekte për ngritje ambientesh për ruajtje të prodhimit, linja për standardizim prodhimi dhe mekanikë bujqësore, të financohet deri në masën 50% të projektit, por jo më shumë se 5,000,000(pese milion) për një subjekt (SHBB).

23.1 Kriteret e përfitimit

1. Përfitues të mundshëm janë të gjitha Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, themeluar sipas Ligjit nr. 38, datë 05.04.2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”, (SHBB);
2. Mbështetja financiare jepet për aktivitetet dhe investimet e mëposhtme:
 - Ngritje ambientesh për ruajtje të prodhimit (magazina të zakonshme ose dhoma frigoriferike);
 - Linja për standardizim prodhimi, (tharje, ruajtje, seleksionim dhe ambalazhim prodhimi);
 - Mekanikë bujqësore;
3. Aktiviteti për të cilën kërkohet mbështetje duhet të jetë identifikuar dhe rekomanduar nga Zyra Ekstensionit të Qarkut përkatës (Komisioni i përbërë nga 3 specialiste);
4. Ambjenti për ruajtjen e prodhimit, linja e standardizimit të prodhimit apo mekanika bujqësore e blerë, duhet të jetë e regjistruar në emër të SHBB-së;
5. Trualli që do të përdoret për ngritje ambientesh për ruajtjen e prodhimit ose për linja standardizimi të jetë në pronësi ose i marrë me qira (për jo më pak se 10 vjet), në emër të SHBB-së;
6. Për ngritje ambientesh për ruajtjen e prodhimit, apo për lindja standardizimi të prodhimit, të sigurohet leja e ndërtimit dhe ambientit lëshuar nga autoritetet ligjore përgjegjëse;
7. Për mekanikë bujqësore do të mbështetet blerja e traktorëve bujqësorë të të gjitha llojeve apo makineri për punimin e tokës si plugje, freza, disqe, makina mbjellëse, pompa spërkatëse dhe kositëse bari;
8. Përfitojnë ato SHBB që kanë jo më pak se 7 **anëtarë** të cilët duhet të jenë të moshës nga 18-65 vjeç dhe jo të së njejtës familje;
9. Në rastin kur SHBB aplikon për mekanikë bujqësore, duhet që anëtarët e saj (së bashku) të kenë në pronësi ose në përdorim (qira për të paktën 10 vjet) jo më pak se 10 ha tokë

bujqësore ose në rastin e atyre SHBB që merren me aktivitete blegtoral jo më pak se 30 krerë gjedh ose 300 krerë të imta.

10. Nuk financohet blerja nga SHBB-të e ambienteve ekzistuese apo e linjave dhe mekanikës bujqësore të përdorur.

11. Anëtarët e SHBB të kenë përmbushur detyrimet e pagesës së taksave:

a. Të kenë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”

b. Të kenë paguar taksën e tokës për vitit 2013.

23.2 Krite konkurruese

a) *Për ngritje ambientesh për ruajtje të prodhimit:*

- | | |
|---|---------|
| • Kapaciteti ruajtes | 30 pikë |
| • Lloji i ambientit (magazinë e zakonshme apo ambient i kondicionuar) | 30 pikë |
| • Numri i anëtarëve të SHBB | 20 pike |
| • Plani Biznesi 3 vjeçar | 20 pikë |

b) *Për linjën e standartizimit të prodhimit:*

- | | |
|--|----------|
| • Standartizim fruta/perime/patate/bime medicinale | 30 pikë; |
| • Kapaciteti perpunues | 30 pikë |
| • Numri i anëtarëve të SHBB | 20 pike |
| • Plani Biznesi 3 vjeçar | 20 pikë |

c) *Për mekanikën bujqësore:*

- | | |
|--|---------|
| • Sipërfaqja e tokës bujqësore apo numri i krerëve që menaxhon SHBB | 40 pikë |
| • Investim i pjesshem ose i plote (Bashku me traktorin, blen edhe një agregat/agregate bujqësore) | 20 pikë |
| • Numri i anëtarëve të SHBB | 20 pikë |
| • Plani Biznesi 3 vjeçar | 20 pikë |

Projektet vlerësohen me pikë sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk financohen.

Procedura që do të ndiqet

a. Aplikimi për SHBB-të

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 01 Mars deri më 30 Prill 2013.

Aplikimet për mbështetje financiare në emër të SHBB bëhet nga përfaqësuesi ligjor i SHBB.

Aplikimet për mbështetje financiare për këtë skemë mbështetëse paraqiten në AZHBR qendër, sipas formularit të aplikimit (**Formulari 23/1**).

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim, aplikanti duhet të dorëzojë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Ekstrakti i regjistrimit të SHBB në QKR (për të gjitha llojet e investimeve);
- b. NIPT i SHBB (për të gjitha llojet e investimeve);
- c. Fotokopje e kartave të identitetit ose pasaportave të gjithë anëtarëve të SHBB (për të gjitha llojet e investimeve);
- d. Çertifikata familjare e çdo anëtar të SHBB (për të gjitha llojet e investimeve);
- e. Dokumenti i noterizuar i dakortësisë së anëtarëve të SHBB për objektin që aplikon (për të gjitha llojet e investimeve);
- f. Dokumentin e pronësisë së tokës së SHBB (në rast të aplikimit për mekanikë bujqësore);
- g. Fotokopje të Regjistri identifikues i numrit të kërësve, regjistri i fermave (Në rastin e SHBB me drejtim blegtoral)
- h. Dokumenti i pronësisë së truallit (në rastin e ndërtimit ambienteve);
- i. Dokumenti i pronësisë së objektit (në rastin e blerjes së linjës);
- j. Kontratën e qirasë me të tretët e noterizuar minimumi 10 vjet për tokën, truallin, objektin (sipas llojit të investimit);
- k. Biznes plani i detajuar (për të gjitha llojet e investimeve);
- l. Raporti i Komisionit të Zyrës së Ekstensionit të Qarkut përkatës për aktivitetin e propozuar për mbështetje financiare;
- m. Vërtetim bankë për numrin e llogarisë (për të gjitha llojet e investimeve);

Kontrata e qirasë në të dyja rastet për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të jetë e noterizuar. Në rastet kur nuk ka përfunduar azhurnimi i tokës bujqësore të përdoret kontrata tip.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje të jetë i noterizuar.

AZHBR bën vlerësimin nga ana formale të aplikimeve së bashku me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimit (**Formulari 23/2**). Një kopje e këtij formulari i jepet aplikantit (Përfaqësuesit ligjor të SHBB).

AZHBR regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në regjistrin e aplikimit të AZHBR (**Formulari 23/3**).

b. Vlerësimi

AZHBR qendër me mbarimin e afatit të aplikimit dhe marrjen e kërkesave, brenda muajit Maj 2013, bën vlerësimin e kërkesave të paraqitura dhe përzgjedhjen e aplikimeve fituese.

“Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, ngrihet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR, dhe përbëhet nga 5 përfaqësues.

Në përbërjen e “Komisionit të Vlerësimit të Projekteve” bën pjesë edhe një anëtar nga “Sektori i Këshillimit dhe Kooperimit Bujqësor në MBUMK.

Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas kritereve të konkurueshmërisë të skemës përkatëse (**Formularët e Vlerësimit 23/4,5,6**).

Niveli maksimal i vlerësimit do të jetë 100 pikë. Fitues mund të jetë çdo aplikim me të paktën 60 pikë.

Brënda 5 ditë pune pas vlerësimit, komisioni i vlerësimit bëjnë renditjen e projekteve sipas rendit zbritës të pikëve nga projektet me pikë maksimale deri te projektet me pike minimale dhe me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR bën shpalljen e listave të projekteve fituese dhe jo fituese në vende publike. **(Formulari 23.7)**

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion AZHBR njofton aplikantët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndiqen deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Pas procesit të vlerësimit, AZHBR duhet të lidhë kontratë me aplikuesin në lidhje me realizimin e investimit.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është realizimi i investimit sipas projektit bashkëngjitur aplikimit.

c. Rregjistrimi i aplikimeve në Data Base

DIT organizon dhe hedh të gjithë informacionin e duhur në lidhje me të gjitha aplikimet për këtë skemë mbështetëse në Data Base.

d. Kërkesa për financim

Sipas llojit të investimit pagesa e grandit do te realizohet me 2-3 këste.

Në përfundim të investimit (ose një pjese të investimit), aplikanti paraqet pranë AZHBR kërkesën për financim sipas formularit bashkëngjitur. **(Formulari 23/8)**. Së bashku me kërkesën për financim aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin e punimeve të kryera;
- Lejen e ndërtimit të lëshuar nga autoritete përgjegjëse për rastin e ngritjes së magazinave, ambienteve të ruajtjes së prodhimit apo linjat e standardizimit.
- Faturen/faturat tatimore të blerjes së linjës së standardizimit/ambienteve ruajtëse të prodhimit/mekanikës bujqësore etj;
- Çertifikatën e origjinës dhe të garancisë së linjës standartizimit të prodhimit/ambienteve ruajtëse/ mekanikës bujqësore sipas standardeve të BE-se;
- Vërtetim nga Komuna/Bashkia dhe mandat arkëtimi përkatës, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2013.
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore” për të gjithë anëtarët e SHBB.

e. Verifikimi dhe pagesa

Për verifikimin e realizimit të investimit sipas projektit dhe situacionit të paraqitur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR ngrihet “Grupi i Verifikimit të Projekteve”, i përbërë nga 4 pjesëtarë:

- Dy përfaqësues nga Drejtoria e Kontrollit AZHBR;

- I përfaqësues (Specialist), i fushës përkatëse që mbështetet;
- Një përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimit Këshillimor dhe Informacionit Bujqësor në MBUMK;

Grupi i verifikimi kryesohet nga AZHBR.

Grupi i verifikimit bën verifikimin në vend të investimit në prani të aplikantit (Përfaqësuesit ligjor të SHBB ose një të deleguari të tij), dhe plotëson në vënd Formularin e Verifikimit (**Formulari 23/9,10,11**). Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi dhe i gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Verifikimi në terren shoqërohet me foto të cilat dokumentojnë investimin e mësipërm në Raportin e Kontrollit.

Grupi i verifikimit brënda 10 ditëve nga përfundimi i verifikimit të projektit dërgon formularin e kontrollit (**Formulare 23/9,10,11**) dhe Raportin përkatës në Drejtorinë e Ekzekutimit të Pagesave.

DEP, pas verifikimit të zbatimit të procedurave të ndjekura është e detyruar që të bëjë xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit.

Kontrolli për administrimin e fondit dhe çështje të tjera.

1. MBUMK dhe AZHBR hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për skemat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfituar mbështetje financiare nga fondi i programit për mbështetjen e prodhimit bujqësor.
2. AZHBR-ja është përgjegjëse për zbatimin, auditimin dhe likuidimin e parave përfituesve sipas skemave të mbështetjes dhe kriterëve të përfitueshmërisë.
3. Ndarjen e fondit të mbështetjes sipas rretheve e bën ose e ndryshon, kur është e nevojshme gjatë zbatimit, Ministri i MBUMK, me propozim të AZHBR dhe DPPB.
4. Masat e mbështetjes kanë kodin e tyre: Ky kod ka formën: MBUMK_2013_01, ku dy shifrat e fundit tregojnë numrin e masës (psh 01 - mbjellja e ullishteve).
5. Çdo aplikant ka kodin e aplikimit. Kodi i aplikimit formohet nga inicialet e qarkut, inicialet e rrethit, numri i masës mbështetëse sipas VKM dhe numri i aplikantit. Numri i aplikantit korrespondon me numrin rendor në Regjistrin e Pranimi të Rrethit për skemën përkatëse. P.sh. Ko/Pg/02/12, tregon aplikimin me numër rendor 12, të rrethit Pogradec, për skemën e mbështetjes mbjellje e arreve.
6. Referuar VKM Nr. . Date , në komisionet e vlerësimit të projekteve për skemat mbështetëse të mbjelljeve të reja, për vlerësimin e aplikimeve të çdo komune do të ketë një përfaqësues të komunës përkatëse (Specialist Bujqësie).
7. Brënda datës 28 Shkurt komunitat dërgojnë zyrtarisht pranë DRB-ve listën e personave përfaqësues të tyre në Komisionet e Vlerësimit të Aplikimeve të skemave të mbjelljeve të reja.
8. Brënda datës 28 Shkurt AZHBR dërgon zyrtarisht pranë DRB-ve listën e personave përfaqësues të tyre në Komisionet e Vlerësimit të Aplikimeve.
9. Brënda datës 10 mars 2013, DRB – të, dërgojnë në AZHBR qendër:
 - a. Listën e përbërjes së Komisioneve të Vlerësimit të Aplikimeve (KVA) për çdo skemë mbështetëse;
 - b. Listën e përfaqësuesve të DRB-ve nëpër grupet e verifikimit të detajuar për çdo rreth dhe skemë mbështetëse.
10. Grupet e Verifikimit të Projekteve ngrihen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR, pas marrjes së propozimit nga DRB -të për përfaqësuesin e tyre në këtë grup. Grupet e verifikimit të projekteve kryesohen nga AZHBR. Përfashtim nga kjo procedurë kanë vetëm skemat me kod MBUMK_2013_09, MBUMK_2013_19 dhe MBUMK_2013_23.

11. Proçedurat e ngritjes së grupeve të verifikimit të këtyre dy skemave jepen në proçedurat e skemave përkatëse. Për arësye objektive bëhen propozimet dhe miratimet për ndryshimet përkatëse në grupet e verifikimit.
12. Referuar VKM Nr. , me fondet e planifikuara të vitit 2013 do të financohen edhe projektet e mbjelljeve të reja të shpallura fituese gjatë vitit 2012. Dokumentacioni dhe të gjitha kushtet e përfitimit do të jenë ato të paraqitura në Udhëzim Nr.2, datë 14.02.2012. Vlera e projektit dhe penalizimet do të bëhet sipas pagesave dhe penaliteteve të skemave përkatëse të përcaktuara në këtë Udhëzim. Për projektet e bimëve medicinale të mbartura nga 2012 të mos kërkohet çertifikatë garancie e materiali mbjellës per Timus ssp.
13. Projektet e mbjelljeve të reja të shpallura fituese gjatë vitit 2012 dhe të verifikuara gjatë vitit 2013, të kalojnë për financim me një këst. AZHBR-ja rikontrollon jo më pak se 10% të projekteve para financimit të tyre.
14. DRB-të janë përgjegjëse për të gjitha proçedurat e aplikimit, vlerësimit, seleksionimit dhe plotësimit të dokumentacionit të aplikantëve nga fondi për mbështetjen e prodhimit bujqësor me përjashtim të skemave mbështetëse me kod aplikimi MBUMK_2013_09, MBUMK_2013_19 dhe MBUMK_2013_23.
15. Hartuesit e projekteve nuk duhet të marrin pjesë në komisionet e vlerësimit dhe të verifikimit të projekteve. Anëtarët e komisioneve të vlerësimit të projekteve nuk duhet të jenë pjesëtarë në grupet e verifikimit të projekteve.
16. I gjithë dokumentacioni që lidhet me vlerësimin dhe verifikimin e projekteve, i plotësuar sipas formulareve bashkëngjitur këtij udhëzimi duhet të jetë pa korrigjime.
17. AZHBR është e detyruar që për një periudhë 10 vjeçare të ruajë dosjen e plotë të dokumentacionit për çdo përfitues (dosja origjinale). Një kopje e të gjithë dosjes së aplikantit ruhet në zyrat rajonale te AZHBR për të paktën 5 vjet.
18. DRB dhe AZHBR raportojnë në mënyrë periodike për menaxhimin e fondit të mbështetjes së prodhimit bujqësor. MBUMK nga ana e saj raporton çdo 3 mujor në MF për ecurinë e realizimit të programit të mbështetjes financiare.
19. Aplikanti përfiton të drejtën e financimit kur ka zbatuar me përpikmëri projektin për të cilën ka aplikuar dhe është shpallur fitues nga vlerësimi i projekteve. Në rastet kur zbatimi i projektit për ndonjë arësye madhore nuk është në përputhje me projektin e paraqitur për vlerësim, AZHBR Qendër vendos për vazhdimësinë e proçedurës deri në përfitimin ose jo të financimit.
20. AZHBR Qendër me një rregullore të brëndëshme jep në mënyrë të detajuar proçedurat dhe qarkullimin e dokumentacionit ndërmjet drejtorive dhe sektorëve të AZHBR-së deri në ekzekutimin dhe likuidimin përfundimtar të përfituesit.

21. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Financave kur e gjykojnë të nevojshme kërkojnë ngritjen e grupit të përbashkët të auditimit për të verifikuar administrimin e fondit.
22. Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar nga përzgjedhja e bërë nga komisioni i vlerësimit paraqesin ankesën e tyre brenda 5 diteve nga shpallja e fituesve prane DPPB të MBUMK, e cila brenda 10 ditëve nga marrja e ankesës bën verifikimin përkatës dhe i jep përgjigje ankuesit.
23. Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar nga përzgjedhja e bërë nga grupi i verifikimit të projekteve apo kanë pretendime nga konkluzioni i grupit të verifikimit paraqesin ankesën e tyre brenda 15 ditë pune nga shpallja e vendimit të grupit të verifikimit. AZHBR qendër brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës bën verifikimin përkatës dhe i kthen përgjigje ankuesit.
24. Kur aplikanti s'kualifikohet gjatë kontrollit administrative në AZHBR qendër, drejtoria/sektori përkatës që ka skualifikuar projektin njofton palën e interesuar për vendimin dhe shkaqet e skualifikimit brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.
25. Në rast se konstatohen shkelje të rregullave në administrimin e fondit nga personat përgjegjës në DRB apo në AZHBR, merren masa disiplinore apo ç'dëmtim për ç'do rast sipas dispozitave ligjore në fuqi.
26. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen AZHBR, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

MINISTRI I FINANCVE
Ridvan Bode

ANEKS 1

Formulari 1

Rajonizimi i pemëve Frutore sipas specieve, mbjellja e të cilave do mbështetet nga Fondi PËR MBËSHTETJE BUJQËSISË.

Nr	QARQET	nr	Rrethet	sipas specieve													
				1.Molla	2.Dardha	3. Ftonj	4.Kumbulla	5.Qershia	6.Pjeshkë	9.shëga	16 Kiwi (Actinidie)	10.Luleshtr ydhe(dredh ëza)	12 Arra	13 Bajame	14 Lajthi		
1	Berat	2	Berat				Tr + P		Tr + P								
		3	Kuçove				Tr + P		Tr + P								
		4	Skrapar				P										
2	Dibër	1	Dibër				Tr + P										
		2	Bulqize				P										
		3	Mat				P	Tr+P	Tr + P								
3	Durr	1	Durres				Tr		Tr + P								
		2	Kruje				Tr		Tr + P								
4	Elbasan	1	Elbasan	Mgj			Tr		Tr + P								
		2	Gramsh				P										
		3	Librazhd				P	Tr+P									
		4	Peqin				Tr		Tr + P								
5	Fier	1	Fier				Tr		Tr + P								
		2	Lushnje				Tr		Tr + P								
		3	Mallakaster				P	Tr+P									
6	Gjiroka	1	Gjirokaster				P + Tr		Tr + P								
		2	Permet				P										
		3	Tepelene				P										
7	Korçë	1	Korçë				Tr + P										
		2	Devoll				P										
		3	Kolonje				P										
		4	Pogradec				P										
8	Kukës	1	Kukes				P										
		2	Has				P										
		3	Tropoje				P	Tr+P									
9	Lezhë	1	Lezhe				Tr		Tr + P								
		2	Kurbini				Tr		Tr + P								
		3	Mirdite				P										
10	Shkodër	1	Shkoder				Tr		Tr + P								
		2	M Madhe				P										
		3	Puke				P										
11	Tiranë	1	Tirane				Tr		Tr + P								
		2	Kavaje				Tr		Tr + P								
12	Vlorë	1	Vlore				Tr		Tr + P								
		2	Delvine				Tr										
		3	Sarande				Tr		Tr + P								
REPUBLIKA																	

REPUBLIKA

Tr - VarieteTryeze ; P - VarietePërpunimi.

Rajonizimi i specieve të pemëve frutore sipas rrethëve është bazuar kryesisht në Studimin e vitit 2009 nga DRBUMK.

Shënim: Mbjellja e pemëve të reja financohet vetëm në terrenet e paracaktuara nga DRBUMK në Studimin e kryer gjatë vitit 2009 dhe në parashikimin e bërë për mbjelljet e reja gjatë viteve 2010-2013.

Mgj: Në qarkun e Elbasanit financohet mbjellja e mollës vetëm në fshatin Mollagjeç, ka një Vrijet Autokton me këtë emër.

Rajonizimi varietor për Ullirin (sipas Studimit perveç qarkut Vlorë)

Formulari 2

[illegible]

Nr	QARQET	nr	Rrethet	sipas specieve			
				1.Portokall e	2. Mandarina	3.Limona	4.Të tjera
1	Berat	2	Berat		x	x	
		3	Kuçove		x	x	
		4	Skrapar				
2	Dibër	1	Dibër				
		2	Bulqize				
		3	Mat				
3	Dur rës	1	Durrës		x	x	
		2	Krujë		x	x	
4	Elbasan	1	Elbasan		x	x	
		2	Gramsh				
		3	Librazhd				
		4	Peqin		x	x	
5	Fier	1	Fier	x	x	x	
		2	Lushnjë	x	x	x	
		3	Mallakastër				
6	Gjirok astër	1	Gjirokastër				
		2	Permet				
		3	Tepelene				
7	Korçë	1	Korçë				
		2	Devoll				
		3	Kolonjë				
		4	Pogradec				
8	Kukës	1	Kukës				
		2	Has				
		3	Tropojë				
9	Lezhë	1	Lezhë		x	x	
		2	Kurbini				
		3	Mirditë				
10	Shkod ër	1	Shkodër		x	x	
		2	M Madhe				
		3	Pukë				
11	Tirā në	1	Tiranë		x	x	
		2	Kavajë		x	x	
12	Vlorë	1	Vlorë	x	x	x	x
		2	Delvinë	x	x	x	
		3	Sarandë	x	x	x	x
REPUBLIKA							
Rajonizimi i specieve të agrumeve sipas rretheve është bazuar kryesisht në Studimin e vitit 2009 nga DRBUMK.							

Shënim: Mbjellja e agrumishteve të reja financohet vetëm në terrenet e paracaktura nga DRBUMK në Studimin e kryer gjatë vitit 2009 dhe në parashikimin e bërë për mbielljet e reja gjatë viteve 2010-2013.

Vreshtave me destinacion Rrush Tryeze, mbjellja e të cilëve mbështetet nga FONDI i ndihmës së
BUJQËSISË

Nr	QARQET	nr	Rrethet	sipas varieteteve												
				1. Black Magic	2. Cardinal	3. Diamante	4. Victoria	5. Afuzali	6. Italia	7. Sulltanin a e Bardhe	8. Perlone	9. Moscat Hamburgu	10. Sublima	11. Michele Paglieri	12. Red Glob	13. Tajka e Kuqe
1	Berat	2	Berat	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX
		3	Kuçove	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
		4	Skrapar													
2	Dibër	1	Dibër	X	X	X	X									
		2	Bulqize													
		3	Mat				X	X	X	X						X
3	Durrës	1	Durrës	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX
		2	Kruje	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
4	Elbasan	1	Elbasan	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX
		2	Gramsh													
		3	Librazhd													
		4	Peqin	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
5	Fier	1	Fier	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
		2	Lushnje	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX
		3	Mallakaster													
6	Gjirok	1	Gjirokaster	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX			
		2	Permet													
		3	Tepelene													
7	Korçë	1	Korçë	XX	XX											
		2	Devoll													
		3	Kolonje													
		4	Pogradec	X	X	X	X									
8	Kukës	1	Kukës													
		2	Has													
		3	Tropoje													
9	Lezhë	1	Lezhë	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX
		2	Kurbin	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
		3	Mirdite	X	X			X	X	X						X
10	Shkodër	1	Shkodër	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX
		2	M Madhe													
		3	Puke													
11	Tiranë	1	Tiranë	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX
		2	Kavaje	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX
12	Vlorë	1	Vlorë	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX
		2	Delvine													
		3	Sarandë	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX	XX

REPUBLIKA

XX	XX	Rajonizimi i Varieteteve për rrush tryeze në rrethet pranë qyteteve të mëdha dhe zonave të turizmit bregdetar
X		Rajonizimi i varieteteve edhe në rrethet e tjera që mbjellin vreshta për rrush tryeze.

Shënim: Mbjellja e vreshtave të reja financohet vetëm në terrenet e paracaktura nga DRBUMK në Studimin e kryer gjatë vitit 2009 dhe në parashikimin e bërë për mbjelljet e reja gjatë viteve 2010-2013.

**Rajonizimi i Vreshtave me destinacion Rrush për Verë të Kuqe, mbjellja e të cilëve
mbështetet nga FONDI i ndihmës së BUJQËSISË**

Nr	QARQET	nr	Rrethet	sipas varieteteve																
				1. Kallmet	2. Debin e zezë	3. Serin i zi	4. Vlosh	5. Sheshi i zi	6. Gemza	7. Merlo'	8. Pinot Nuar	9. Kabernet Sovignon	10. Monte Pulciano	11. Tempra nillo	12. Vranac	13. Primitiv a	14. Syrah	15. Sangiove ese	16. Mavrud	17. Barbera
1	Berat	2 Berat				xx				xx	xx	xx	xx	xx		xx	xx	xx	xx	xx
		3 Kuçove			x					x	x	x	x	x		x	x	x	x	x
		4 Skrapar		xx	xx					xx	xx	xx								xx
2	Dibër	1 Diber								x	x	x								x
		2 Bulqize								x	x	x								x
		3 Mat								x	x	x								x
3	Durrës	1 Durrës						xx		xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx
		2 Kruje						x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
4	Elbasan	1 Elbasan						xx		xx	xx	xx	xx	xx		xx	xx	xx	xx	xx
		2 Gramsh		x	x					x	x	x						x		x
		3 Librazhd								xx	xx	xx								xx
		4 Peqin						x		x	x	x	x	x		x	x	x	x	x
5	Fier	1 Fier				xx				xx	xx	xx	xx	xx		xx	xx	xx	xx	xx
		2 Lushnje								x	x	x	x	x		x	x	x	x	x
		3 Mallakaster					x			x	x	x	x	x		x	x	x		x
6	Gjirokastrë	1 Gjirokastrë		xx	xx					xx	xx	xx	xx	xx		xx	xx	xx		xx
		2 Permet		xx	xx					xx	xx	xx	xx	xx		xx	xx	xx		xx
		3 Tepelene		x	x					x	x	x						x		x
7	Korçë	1 Korçë				xx			xx	xx	xx	xx								xx
		2 Devoll				x			x	x	x	x								x
		3 Kolonje		xx	xx					xx	xx	xx								xx
		4 Pogradec				xx			xx	xx	xx	xx								xx
8	Kukës	1 Kukës								x	x	x								x
		2 Has								x	x	x								x
		3 Tropoje								x	x	x								x
9	Lezhë	1 Lezhë	xx							xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	x
		2 Kurbin	x				x			x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
		3 Mirdite	xx							xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx		xx
10	Shkodër	1 Shkodër	xx							xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx
		2 M Madhe	xx							xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx	xx
		3 Puke	x							x	x	x			x					x
11	Tiranë	1 Tiranë					xx			xx	xx	xx	xx	xx		xx	xx	xx	xx	xx
		2 Kavaje					x			x	x	x	x	x		x	x	x	x	x
12	Vlorë	1 Vlorë				xx				xx	xx	xx	xx	xx		xx	xx	xx	xx	xx
		2 Delvine				xx				xx	xx	xx	xx	xx		xx	xx	xx		xx
		3 Sarandë				xx				xx	xx	xx	xx	xx		xx	xx	xx	xx	xx

REPUBLIKA

xx Rajonizimi i varieteteve në rrethet që përpunojnë më shumë rrush për verë

x Rajonizimi i varieteteve edhe në rrethet e tjera që mbjellin vreshta për rrush vere.

Shënim: Mbjellja e vreshtave të reja financohet vetëm në terrenet e paracaktura nga DRBUMK në Studimin e kryer gjatë vitit 2009 dhe në parashikimin e bërë për mbjelljet e reja gjatë viteve 2010-2013.

Rajonizimi i bimëve medicinale 2012

Nr	Qarqet	Shërbela	Rigini	Lavandula	Timusi	Rozmarina
1	Berat			x	x	
2	Gjirokaster			x	x	
3	Shkoder		x			
4	Dibër		x	x	x	x
5	Lezhë		x	x	x	
6	Durrës	x		x	x	
7	Tiranë					
8	Fier	x		x	x	
9	Vlorë			x	x	

 Qarqet ku mbështetet kultivimi i bimëve mjekësore e aromatike

Numri minimal i bimëve për 1 ha, sipas specieve

(për efekt financimi të mbjelljeve të reja dhe instalimit të sistemit të ujitjes me pika në vitin 2013)

Nr	Speciet	Për format tradicionale të kultivimit rr/ha	Për format intensive të kultivimit rr/ha
I.	Pemë Frutore		
1.	Molla	300	800
2.	Dardha	400	800
3.	Ftoi	400	800
4.	Kumbulla	300	500
5.	Qershia	250	400
6.	Pjeshka	400	700
7.	Shega	500	700
8.	Arra	200	x
9.	Bajamja	300	500
10.	Lajthia	500	700
11.	Kivi	500	700
12.	Luleshtrydhe	60-80 mijë bimë/ha në fushë të hapur dhe në tunele plastmasi	60-80 mijë bimë/ha në serra me klimë të kontrolluar
II.	Ulliri	178	400
III.	Agrume -Me Nënshartese Nerënxë e Citromelo -Me Nënshartese Trifoljatë	400 500	500 660
IV.	Vreshta		
1.	Për rrush tryeze	2000	x
2.	Për rrush vere	3300	x
V	Bimët medicinale		
1	Sherebela	40 000	x
2	Rigon	40 000	x
3	Lavandula	10 000 (në toka normale)	20 000 (në toka të varfëra skeletike)
4	Timus	80 000	x
5	Rozmarina	20000 (2 bime/m ²)	x
VI	Bostanoret		
1	Pjepër	7 500	x
2	Shalqi	4 000	x

ANEKSI 3

UDHEZIM PER PROJEKTET E STALLES SE LOPEVE TE QUMESHTIT

Projekti i stalles do te vleresohet me 20 pike nga te cilat

Nje projekt ndërtimi stalle për 1 lopë qumështi të ketë:

A. Planimetrine e stallës (prerje horizontale dhe tërthore)

B. Sistemi i mbarështimit të lopëve (të lirë, e lidhur) dhe mënyra e lidhjes së lopëve (Kokë më kokë apo me renditje)

C. Parametrat e stallës të dhenë sipas sistemeve të mëposhtëm:

Normat e strehimit të kafshëve sipas sistemit të mbajtjes së gjedhit

1- Rekomandimet e strehimit për sistemin e lirë (lopë të palidhura)

Nr	Treguesit	Njësia	Parametrat e rekomanduar	Pikë
1	Sipërfaqja	m ² /krerë	5.6 -10	3
2	Vëllimi	m ³ /krerë	16	3
3	Gjatësia e shtratit të fjetjes +jastëku	m	2.1-2.3	3
4	Gjërësia e shtratit të fjetjes	m	1.1-1.2	3
5	Gjatësia e vënd-qëndrimit te lopes për tu ushqyer + sip. e mocionit të kafshës	m/krerë	4-5	2
6	Gjërësia e vënd – qëndrimit te lopes për tu ushqyer.	m/krerë	1.2	2
7	Gjërësia e sipërfaqes për të ushqyerin	M	2 – 3	2
8	Pedenca e stallës në drejtim të rrjedhjes (urinë,jashtëqitje, ujra larës etj)	%	2 – 3	2
	Totali pike			20

2-Rekomandimet për sistemin e lidhur. (lopë të lidhura)

2.1 Rekomandimet e strehimit për rracat e lehta

Rraca të lehta: Rraca e lopëve të vëndit ; Xhersi ; Kryqëzime të xhersit me racën e vëndit.



Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
Drejtoria e Politikave të Prodimit Bujqësor

a. Sistemi i lidhur, kokë më kokë

N/r	Treguesit	Njësia	Parametrat e rekomanduar	Pike
1	Sipërfaqja	m ² krerë	5-6	3
2	Vëllimi	m ³ krerë	12 -15	3
3	Koeficienti i ndricimit natyral.= KnF		1;15	3
4	Gjatësia e shtratit	m	1.45	3
5	Gjërësia e shtratit	m	0.9	3
6	Gjërësia e koridorit qëndror	m/krerë	1.5 -2	1
7	Gjërësia e koridorit anësor	m/krerë	0.5 – 0.7	1
8	Gjërësia e kanalit të urines	m/krerë	0.2-0.4	1
9	Gjërësia e grazhdit	m/krerë	0.5 – 0.7	2
	Total			20

b. Sistemi i lidhur me renditje lopes ose ne nje krah

N/r	Treguesit	Njësia	Parametrat e rekomanduar	Pike
1	Sipërfaqja	m ² krerë	5-6	3
2	Vëllimi	m ³ krerë	12-15	3
3	Koeficienti i ndricimit natyral.= KnF	m ²	1:15	3
4	Gjatësia e shtratit	M	1.45	3
5	Gjërësia e shtratit	M	0.9	3
6	Gjërësia e koridorit të ushqyerit	m/krerë	1-1.5	1
7	Gjërësia e koridorit anësor	m/krerë	0.5 – 0.7	1
8	Gjërësia e kanalit të urines	m/krerë	0.2-0.4	1
9	Gjërësia e grazhdit	m/krerë	0.5 – 0.7	2
	Total			20

2.2 Rekomandimet e strehimit për rracat e renda

Raca të rënda; Holshtejn; Simental; Bruna; Taranteze si dhe kryqëzimet e tyre

1- a. Sistemi i lidhur, kokë më kokë

N/r	Treguesit	Njësia	Parametrat e rekomanduar	Pike
1	Sipërfaqja	m ² krerë	5-6	3
2	Vëllimi	m ³ krerë	14 -15	3
3	Koeficienti i ndricimit natyral.= KnF	m ²	1:10	3



4	Gjatësia e shtratit	m	1.7-1.8	3
5	Gjërësia e shtratit	m	1-1.2	3
6	Gjërësia e koridorit qendror	m/krerë	2-2.5	1
7	Gjërësia e koridorit anësor	m/krerë	0.5 – 0.7	1
8	Gjërësia e kanalit të urines	m/krerë	0.2	1
9	Gjërësia e grazhdit	m/krerë	0.5 – 0.7	2
	Total			20

b. Sistemi i lidhur me renditje lopes ose ne nje krah

N/r	Treguesit	Njësia	Parametrat e rekomanduar	Pike
1	Sipërfaqja	m ² krerë	5-6	3
2	Vëllimi	m ³ krerë	14 -15	3
3	Koeficienti i ndricimit natyral.= KnF	m ²	1,10	3
4	Gjatësia e shtratit	m	1.8	3
5	Gjërësia e shtratit	m	1-1.2	3
6	Gjërësia e koridorit te sherbimit te ushqimit	m/krerë	0.7-1	1
7	Gjërësia e koridorit anësor	m/krerë	0.5 – 0.7	1
8	Gjërësia e kanalit të urines	m/krerë	0.2-04	1
9	Gjërësia e grazhdit	m/krerë	0.5 – 0.7	2
	Total			20

$$KnN = \frac{\text{sipërfaqja dritareve}}{\text{Sipërfaqja e stallës}}$$

Për vlerësimin e kriterit konkurrues “**Strehimi i kafshëve**”, sipas tipit të stallës që ka aplikanti, përdoret pikëzimi i detajuar në tabelat e mësipërme.

Pikët maksimale për treguesit e detajuar i marrin aplikimet, stallat e të cilave plotësojnë minimalisht treguesi minimal të dhënë në tabelë. Kur një nga treguesit e mësipërm është nën shifrën e treguesit minimal, aplikimi merr 0 pikë, për atë tregues.